



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG
KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

R A P O R T

I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN
JANAR- DHJETOR 2022

Janar 2023

Udhëheqësi i Komunës

Komuna si njësi themelore e pushtetit lokal funksionon në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/08), Statutit të Komunës si akt më i lartë i komunës si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fushëveprimi i saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal dhe Komunave iu është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, përkatësisht përcaktimit të numrit të tyre. Në këtë kontekst si organe të Komunës në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale janë përcaktuar: Kryetari si organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe Kuvendit Komunal si organ më i lartë vendimmarrës.

Kryetari i Istog-ut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale në vitin 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës mbanë 11 nga 27 ulëset në Asamblenë Komunale. Partia e dytë më e madhe me 7 ulëse është AAK, e përcjellur nga VV me 5 anëtarë të asamblesë, PDK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Komiteti për Barazi Gjinore dhe Komitete tjera siç parashihen me ligj. Komuna e publikon procesverbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 12 Drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim duke shtuar Zyrën e Kryetarit përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

KRYETARI I KOMUNËS

Kryetari është organ më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale dhe atë:

- Realizimi i projekteve me prioritet të përcaktuara nga viti i kaluar dhe realizimi i projekteve të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve;
- Organizimi dhe funksionimi i organeve komunale të administratës dhe kompletimi i tyre me kuadro profesionale, në këtë drejtim është angazhim permanent në organizimin dhe sistemin e shërbimit civil në atë mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuara për kryerjen e shërbimeve komunale
- Hartimi dhe propozimi i Rregulloreve dhe Vendimeve të ndryshme nga fushëveprimi dhe kompetencat komunale, të cilat i janë kaluar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit për miratim
- Si dhe punët dhe detyrat të tjera të rregullta nga fushëveprimi dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në 6 mujorin e punës për vitin 2022 ka nënshkruar gjithësej 16 (gjashtëmbëdhjetë) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, MBPZHR-në, KFOR-in, Këshillin Evropian, Fondin Kosovar për Eficiencë të Energjisë, Organizata Joqeveritare(OJQ) etj.

Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: Zyra e integriteteve evropiane, Zyra ligjore, Zyra e komunikimit dhe informimit, Zyra e menaxherit të personelit, Avokati publik dhe Auditori i brendshëm. Në kuadër të zyrës së integriteteve evropiane dhe zyrës ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të zyrës së informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe media elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, drejtorive dhe punës në përgjithësi të organeve komunale të administratës si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e Ueb faqes së komunës. Gjatë periudhës një vjeçare nga janari deri në dhjetor 2022 janë realizuar 14 procedura rekrutimi të pranimit (konkurse të jashtme) që kanë rezultuar me kandidat të suksesshëm si 4 procedura që janë procedurë e sipër të realizimit. Po ashtu janë realizuar edhe 2 procedura të brendshme të rekrutimit të lëvizjes në kategori të cilat kanë rezultuar me kandidat të suksesshëm. Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Gjatë viti të parë të qeverisjes është bërë një punë mjaft e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë, identifikimi i prioriteteve të tjera pastaj vazhdimi i prioriteteve të cilat janë realizuar e që do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorive përkatëse. Krahas këtyre synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera: si kontaktimi me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së, EULEX-it, ICO-së, KFOR-it dhe vizitave të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, Komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë 6 muajor.

SEKTORI LIGJOR

RAPORTI I PUNËS PËR PERIDHËN JANAR-DHJETOR 2022

Zyra ligjore ka kryer punët si me poshtë :

Zyra e Kryetarit të Komunës- ekzekutivi ka pranuar:

Kërkesa 374 ;

Në proces-268,

Miratuar- 69,

Refuzuar-31,

Hedhur poshtë- 0,

Pezulluar - 0,

Ceduar- 0,

Anuluar- 5,

Përfunduar - 0

Për Kryetarin e Komunës- ekzekutivin:

Janë nxjerrë:

- 856 (tetqind e pesëdhjet e gjashtë) Vendime;
- 26 (njëzet e gjashtë) Kontrata;
- 15 (pesmbëdhjetë) Marrëveshje;
- 90 (nëdhjetë) Shkresa të ndryshme;
- 14 (katërmëdhjetë) Autorizime;
- 8 (tetë)Propozim;
- 1(një) Njoftim;

Është punuar në grupe punuese për hartimin e rregulloreve komunale; Puna në grupe punuese për

hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të ndryshme; Puna për mbledhjen e të dhënave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2022 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së, Puna në komisione të ndryshme; Shpërndarja e Gazetave Zyrtare-Ligjeve në organet komunale; Bashkëpunimi-konsultimi me Drejtorët e Drejtorive si dhe zyrtarët komunal lidhur me zbatimin e ligjeve; Punimi i raporteve për MAPL-në si dhe punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lëndëve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime; në tryeza të rrumbullakëta; në konferenca; si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi. Është punuar në grupe punuese për hartimin e rregulloreve komunale; Puna në grupe punuese për hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të ndryshme; Puna në grupin punues për funksionimin e organeve të administratës komunale; Puna për mbledhjen e të dhënave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2022 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe KPF-së; Puna në komisione të ndryshme; Shpërndarja e Gazetave Zyrtare-Ligjeve në organet komunale; Bashkëpunimi-konsultimi me Drejtorët e Drejtorive si dhe zyrtarët komunal lidhur me zbatimin e ligjeve; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lëndëve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime; në tryeza të rrumbullakëta; në konferenca; si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi.

ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE RAPORTI I PUNËS PËR PERIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Zyra për Integritet Evropian (ZIE) ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhje me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian. Zyra në fjalë, mbikëqyrë aktivitetet e drejtorive dhe sektorëve që burojnë nga planet e Veprimit për Partneritet Evropian, obligimet e komunës që dalin nga Agjenda evropiane 2022 e që ka të bëjë me Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA) si dhe dokumentet tjera strategjike të MAPL-së, respektivisht Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të përgjegjësisë të Zyrës për Integritet

Evropiane, zyrtari përgjegjës në vazhdimësi mbikëqyrë hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar se ato janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal. Aktualisht, jemi në përgatitje të Raportit 1 vjeçar (Janar-Dhjetor 2022), raport ky që pasqyron përmbushjen e obligimeve të komunës nga fusha e agjendës evropiane.

ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM RAPORTI I PUNËS PËR PERIDHËN JANAR-QERSHOR 2022

Zyra e Auditorit të brendshëm në komunën e Istogut është i organizuar si Njësi e Auditimit të Brendshëm (NJAB) që vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit komunës me një Auditor të brendshëm. Puna e NJAB bazohet në bazë të Planit vjetor që aprovet dhe miratohet nga Kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit sipas Ligjit nr. 06/L-021 KBFP neni 23 pika 1.2 si dhe neni 25 pika 3.3. Gjatë vitit 2022 në NJAB është finalizuar Raporti për Zyrën e tatimit në pronë, Raporti i auditimit në drejtorinë e shëndetësisë me fushëveprim të hyrat nga participimi për shërbimet shëndetësore dhe shpenzimet e karburantit për vitin 2021- 2022 si dhe është në proces të finalizimit Raporti për menaxhimin e pasurive jo financiare të komunës. Raportet finale nga auditimi i brendshëm janë shqyrtuar në Komitetin e Auditimit lidhur me të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i Auditimit është funksionalizuar me zgjedhjen e kryesuesit të ri dhe një anëtare që ishte më parë në Komitet të Auditimit është rizgjedhur. Është hartuar plani vjetor për vitin 2023 dhe plani strategjik i NJAB për vitet 2023-2025 të cilët po ashtu janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komiteti i Auditimit.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM RAPORTI I PUNËS PËR PERIDHËN JANAR-DHJETOR 2022

Gjatë kësaj përudhe, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitete të Komunës së Istogut. Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut. Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj mbi 400 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Istogut në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi menaxhimin si dhe aktivitete të përditshme të komunës sonë. Ueb-sajti i komunës sonë pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnit të ueb-faqës komunale nga ana e MAPL-së, çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e

ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës. Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqën e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Po ashtu vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës ku janë të publikuar rreth 622 vendime, si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje. Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb. Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre. Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për Qasje në Dokumente Publike. Gjate periudhës Janar-Dhjetor janë pranuar 17 kërkesa, ku të gjithave u është lejuar qasja dhe të gjitha këto kërkesa janë përfunduar në afatin e paraparë me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Avokati publik- Punët-detyrat e punës të caktuara me programin e punës për periudhën raportuese e për të cilat është caktuar mbajtja e shqyrtimit në tërësi janë realizuar

QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETAR

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, për një vit:

Nr.	Drejtorati/Departamenti	Të pranuar	Të arkivuara
00	Kuvendi Komunal	08	7
01	Zyra e Kryetarit	229	196
02	Drejtoria e Administratës	65	50
03	Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë	1554	1454
04	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim,	66	66

05	Drejtoria për Arsim	872	772
06	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	371	133
07	Drejtoria e Inspektionit	100	19
08	Drejtoria për ShPMSH	774	760
09	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë	342	300
10	Zyra për Komunitete dhe Kthim	50	7
11	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	528	428
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	110	99
13	Drejtoria për Bugjet dhe Financa	13	10

Gjithsej:

5.082+4.301
=9,383

Numri i dokumenteve të lëshuara/procesuara për një vit:

Nr.	Lloji i dokumentit	Totali
1	Deklaratë për Mbajtës të Familjeve	258
2	Protokolli dalës shkresa të Ministrive të protokolluara	257
3	Ekspedimi i postës Rek. dërgesave në postë-përgjigje nga Drejtoritë K.K	639
4	Pranimi i dërgesave nga posta në K.K-Istog	641

Gjithsej:

1.795

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022

Drejtoria për Administratë Komunale është drejtoria më e madhe dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësi, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë. Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Në kuadër të kësaj drejtorie për këtë periudhë raportuese janë përfunduar këto projekte:

1. "Blerja e pajisjeve të Teknologjisë Informative për nevoja të institucioneve komunale në Istog", vlera 10.000 €;
2. "Mirëmbajtja e objekteve të Administratës komunale në komunën e Istogut", vlera 49.000 €;
3. Instalimi i kamerave në objektin e komunës dhe jashtë objektit, vlera e projektit 8,500.00 €;
4. Blerja e inventarit të zyrës, për shërbyesit civil, në vlerë prej 6,000.00 €
5. Janë funksionalizuar 5 (pesë) e-Kioska në komunën e Istogut", në funksion të qytetarëve në Zyrat e vendit Vrellë, Banjë, Rakosh, Gurrakoc dhe në hapësirat e oborrit të objektit të Komunës ku qytetarët mund t'i tërheqin 5 dokumente të Gjendjes Civile 24/7
6. Certifikatat të cilat mund të tërhiqen në e-kiosqe janë:
 Certifikatën e Lindjes
 Ekstraktin e Lindjes

Certifikatën e Martesës
Certifikatën e Shtetësisë dhe
Certifikatën e Vendbanimit

6. Komuna në bashkëpunim me ASHI (Agjensionin e Shoqërisë së Informacionit) ka plasuar përmes Platformës E- Kosova e cila është vendosë edhe në ueb faqën e komunës së Istogut
7. kk.rks-gov.net/Istog ku qytetari mund të aplikoj dhe t'i tërheq dokumentet e gjendjes civile online e që janë valide për te gjitha shërbimet brenda Kosovës.
8. Po ashtu përmes Platformës E-Kosova, Komuna në bashkëpunim me ASHI ka bërë të mundur aplikimin që qytetari të bëjë pagesën e faturës për takse komunale për regjistrim te automjeteve.
9. Komuna në bashkëpunim me MAPL është duke bërë rifreskimin dhe azhurnimin e Intranetit komunal ku pala përmes Intranetit në 3 faza mund të aplikoj për Leje Ndërtimore.

Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato deri tani janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë. Drejtoria për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Sektori për administratë;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Zyra për të drejtat e njeriut dhe Komunitete.

Sektori i Gjendjes Civile

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, profesionale ndaj qytetarëve përveç Zyrës së Gjendjes Civile në Istog në të cilën përfshihet edhe janë funksionale Zyra e Gjendjes Civile në Gurrakoc (në të cilën përfshihet edhe Zyra e Gjendjes Civile në Dobrushë) dhe në Banjë, ku qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale civile. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë, e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në: Istog, Gurrakoc, Vrellë dhe Banjë. Në kuadër të punëve të rregullta administrative nga administrata e përgjithshme bëhet regjistrimi në librin amë të të lindurve, të kurorëzimit dhe librin amë të vdekurve. Gjithashtu ushtrohen edhe procedura të tjera administrative siç janë: dhënia e vërtetimeve të ndryshme mbi vendbanimin, gjendjes familjare, martesore etj, pranimi i kërkesave dhe shkresave të ndryshme të drejtuara organeve komunale, vërtetimi i dokumenteve zyrtare, ndihma të rregullta juridike për qytetarët. Shërbimi i Gjendjes Civile, si sektor në kuadër të

Drejtoria për Administratë Komunale ka pas në vazhdimësi volum të lartë të punëve edhe gjatë vitit 2022 sikurse në vitet tjera paraprake. Bazuar në të dhënat e ofruara nga ky shërbim gjatë vitit 2022 janë lëshuar 22.630 dokumente për përdorim të brendshëm, në këto dokumente përfshihen: certifikatat e lindjes, ekstrakte nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikata të shtetësisë, certifikata të martesës, certifikata të vdekjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të gjendjes martesore, deklarata të bashkësisë familjare dhe vërtetime nga arkivi. Kurse dokumente për përdorim të jashtëm janë lëshuar 24.167 dokumente , përfshirë: certifikatat e lindjes, ekstrakte nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikata të shtetësisë, certifikata të martesës, certifikata të vdekjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të gjendjes martesore, deklarata të bashkësisë familjare dhe vërtetime nga arkivi. Në total numri i dokumenteve të lësuara nga ky shërbim është 46.797

Ko mun a	Certifi katë e lindje s	Ekstra kt nga Regjist ri	Certifi katë e shtetë sisë	Certi fikat ë e mart	Certif ikatë e vdekj	Certif ikatë e vend	Certif ikatë e gjend	Dekla ratë e bashk ësisë	Vërt etim nga arki	Tota li
----------------	----------------------------------	-----------------------------------	-------------------------------------	-------------------------------	-------------------------------	------------------------------	-------------------------------	-----------------------------------	-----------------------------	------------

dokumente të gjendjes civile

Gjatë vitit 2022 janë pranuar 195 kërkesa prej tyre si në vijim:

1. 78 kërkesa për regjistrimin e vdekjes së mëvonshme dhe lëshuar 78 aktvendime
2. 25 kërkesa për regjistrimin e lindjes së mëvonshme dhe lëshuar 25 aktvendime
3. 34 kërkesa për korrigjimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit) dhe lëshuar 34 aktvendime
4. 38 kërkesa për ndërrimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit) dhe lëshuar 38 aktvendime dhe
5. 20 kërkesa për korrigjimin e dokumenteve të arkivuara dhe lëshuar 20 aktvendime

Së fundmi duhet cekur se shërbimit të gjendjes civile do t'i shtohet edhe 3 zyrtarë të gjendjes civile, dy për në zyrën e gjendjes civile në Istog dhe një për në zyrën e gjendjes civile në Rakosh dhe e gjitha kjo është duke u bërë ashtu që të kemi shërbime sa më të shpejta për qytetarë. Lista e dokumenteve të lësuara dokumentet e lësuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të brendshëm (Periudha e raportimit: 01/01/2022 - 31/12/2022)

			Qendr or i Gjendj es Civile		esës	es	bani mi	jes marte sore	familj are	vi	
1	Isto g	4092	9688	139	3552	1746	1622	543	854	394	2263 0
	Tota li	4092	9688	139	3552	1746	1622	543	854	394	2263 0

Dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të jashtëm,

	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimi	Certifikatë e gjendjes martesore	L e b f
1	Istog	9615	4115	293	3924	807	1143	445	3
	Totali	9615	4115	293	3924	807	1143	445	3

Sektori për Administratë

Në kuadër të këtij sektori janë: udhëheqësi i sektorit, shërbimi i Teknologjisë së Informimit (2 IT), autoparku (2 shërbyes), zyrtari për logjistikë (1 shërbyes), shërbimi i përkthimit (2 shërbyes) dhe shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objektit të komunës (5 stafi administrativo mbështetës, prej të cilëve dy me kontratë të afatizuar një vjeçare).

Gjatë viti 2022, stafi kryesisht janë marr me realizimin e punëve: mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe intranetit, instalimi i programeve softuerike në kompjuterët e stafit civil, mirëmbajtja dhe riparimet softuerike të kompjuterëve të tërë stafit civil dhe politik të administratës komunale dhe punë të tjera të teknologjisë së informimit. Shërbimi i përkthyesve gjatë periudhës raportuese ka bërë përkthime të të gjitha dokumenteve për Kuvendin e komunës dhe komitetet e tij, për nevoja të Kryetarit të Komunës dhe tërë administratës komunale. Në këto përkthime janë përfshi edhe përkthimet simulantë dhe përkthime të tjera gjatë takimeve të ndryshme të organizuara nga administrata komunale. Nga stafi i autoparkut është bërë furnizimi i rregullt i të gjitha automjeteve zyrtare me karburante dhe evidenca e shpenzimeve të tyre sipas drejtorive komunale, është bërë mirëmbajtja e automjeteve, duke u kujdesur që të gjitha automjetet të jenë në gjendje funksionale. Nga zyra e logjistikës është bërë, sipas kërkesës së stafit, furnizimi me material të nevojshëm për zyre dhe furnizim me material higjeniko-sanitar. Nga shërbimi i mirëmbajtjes, është bërë mirëmbajtja e objektit të komunës në aspektin e pastërtisë të të gjitha zyrave, nyjave sanitare dhe korridoreve, mënjanimi i defekteve dhe riparimi i prishjeve të

dyerve, dritareve mobileve dhe karrigeve të stafit si dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore të objektit të komunës, duke përfshirë edhe furnizimin me lëndë djegëse. Në kuadër të Drejtorisë, shqyrtohen kërkesa për vijimin e stazhit të praktikës, si nga ata/ato që kanë përfunduar studimet, në të gjitha fakultete, si në ato private dhe publike dhe studentët të cilët ende i vijnë studimet, po ashtu në të gjitha fakultetet, pa dallim, si ato private dhe publike. Gjatë viti 2022 parashtruara nga individë të cilët kanë kryer fakultetet, si në ato publike. Gjatë vitit 2022 kanë qenë 26 kërkesa për vijimin dhe vazhdimin e punës praktike. Të gjitha janë miratuar dhe të njëjtit kanë vijuar, disa ende vijnë stazhin e praktikës nëpër të gjitha organet e administratës komunale. Deri tani nuk kemi asnjë vërejtje sa i përket sjelljeve të praktikantëve nga ana e stafit të administratës komunale, dhe po ashtu nuk kemi ndonjë vërejtje as nga ana e praktikantëve.

Arkivi komunal

Në kuadër të administratës kryhen edhe shumë punë të përbashkëta administrative për nevoja të organeve komunale, ndër to edhe arkivimi i të gjitha shkresave dhe lëndëve të rëndësishme. Për periudhën raportuese Janar-Qershor të vitit 2022 punëtorët e Arkivit Komunal në Istog janë orientuar në ndarjen dhe klasifikimin e lëndës arkivore. Për periudhën raportuese gjashtëmujore Janar - Qershor 2022 janë shqyrtuar 10 (dhjetë) kërkesa të palëve. Kërkesat që janë paraqitur janë edhe të natyrës së studimit dhe hulumtimit të lëndës arkivore me qëllim të përgatitjes së temave të diplomës për studimet pasdiplomike. Këtyre studiuesve në tri raste u është ofruar lëndë e mjaftueshme arkivore për hulumtime shkencore. Të kësaj natyre janë paraqitur tri kërkesa. Është shtuar edhe numri i kërkesave edhe për hulumtimin e lëndës arkivore sa i përket çështjes së arsimit në periudhën 1989-1999. Interesimi kryesor ka qenë ofrimi i lëndës arkivore për mënyrën e organizimit të mësimin në Shtëpitë-Shkolla sfidat dhe peripecitë që i kanë përjetuar nxënësit dhe mësimdhënësit e kësaj periudhe në këto shtëpi-shkolla. Kryesisht në këtë drejtim me muaj të tërë i është ofruar material arkivor me qëllim të botimit të tij, autorit Bajram Shatri. Fokus kryesor i tij ka qenë funksionimi i shtëpive-shkolla në Komunën e Istogut. Nuk është i vogël edhe numri i kërkesave në rritje kryesisht nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës , gjegjësisht Njësi i Hulumtimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

Kërkesat kishin të bënin kryesisht me hulumtimin e lëndës arkivore që kishte të bënte me evidencën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës .

Aktiviteti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në periudhën 1998-Qershor- 1999. Qëllim i hulumtimit të lëndës arkivore të kësaj natyre ishte pasqyrimi i qartë i të dhënave për evidencën që posedon Arkivi i Komunës së Istogut për Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës, viktimave civile të luftës dhe dëshmorëve. Njëkohësisht këtij Komisioni hetimor i është kërkuar edhe ofrimi i lëndës arkivore që është siguruar nga Shtabi I UÇK-së për Rajonin e Dukagjinit, kuptohet për çështjet që nuk janë të ndjeshme (që nuk paraqesin sekrete zyrtare). Nga të dhënat e ofruara ekipi i hetuesve është ndarë i kënaqur me lëndën e ofruar në shërbim të tyre.

Për periudhën raportuese numri i kërkesave që kishin të bënin me sigurimin e të dhënave për ndryshimet statusore të qytetarëve si janë ndryshimi i emrit, mbiemrit, gurëzimet e lejuara nga Gjendja civile për çështje statusore për të cilat u është lejuar me aktvendim ndryshimi i çështjeve statusore .

Është shtuar edhe numri i kërkesave të paraqitura nga bizneset private për veprimtarinë ekonomike që kanë zhvilluar në periudha të ndryshme kohore. Kërkesat kishin të bënin me ofrimin e të dhënave që posedon arkivi Komunal me stazhin e punës së këtyre veprimtarive afariste, për realizimin e të drejtës në pension dhe të drejtave tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës .

Është punuar në klasifikimin e lëndës arkivore që është dorëzuar nga punëtorja e Arkivit Komunal, Znj Xhevahire Ibrahimaj. Kjo lëndë arkivore është pranuar në gjendjen siç ishte i pa klasifikuar. Për këtë jemi përkushtuar në klasifikimin e kësaj lënde arkivore me qëllim ruajtje.

Është pranuar edhe material arkivor nga Zyra e Prokurimit. Materiali arkivor i dorëzuar nga kjo zyrë nuk është pranuar me procesverbal nga se nuk ishte i sistemuar dhe evidentuar siç e kërkon Ligji për Arkivat dhe Udhëzimi Administrativ për klasifikimin e lëndës arkivore .

Lënda arkivore e dorëzuar pa procesverbal dhe regjistër të lëndës arkivore të futur në regjistratorë është e vitit 2009;2010;2013;2014;2015 dhe 2016. Klasifikimi i këtij materiali arkivor dhe arkivimi i tij mund të bëhet vetëm pas pranim dorëzimit të rregullt me procesverbal dhe regjistër për secilin regjistratorë.

Qendra për shërbim të qytetarëve.

Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtoritë, kryetarit dhe kuvendit.

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, Gjatë vitit 2022:

Shkurtesa	Përshkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratu ar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezuluar	Ceduar	Anulu ar	Përfunduar	Total i
DAP	Drejtoria për Administratë dhe Personel	60	229	1,580	3	0	0	0	13	32,208	34,093
DBZ HR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	22	220	123	0	0	0	11	0	376
DEZ H	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	0	4	141	34	0	0	0	0	0	179
DKR S	Drejtoria për Arsim	5	101	2,565	516	0	9	0	69	0	3,265
DPI	Drejtoria për Punë të Inspeksionit	0	14	70	13	2	1	0	0	0	100
DSH MS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	2	119	856	39	0	0	0	4	0	1,020
DSH PS	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	1	163	409	231	1	1	0	3	0	809
DGJK P	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	10	121	7,746	6	0	0	0	6	0	7,889
KK	Kryetari i Komunës	1	280	69	20	0	0	0	5	0	375
ZLK	Zyra Lokale e Komuniteteve	0	44	10	0	0	0	0	0	0	54
KK	Kuvendi Komunal	0	0	7	2	0	0	0	0	0	9
DPU	Drejtoria për	0	64	546	51	13	133	0	16	0	823

M	Planifikim Urban dhe Mjedis										
DKR S	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	0	71	27	0	2	0	21	0	121
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3	20	5,410	2	0	0	0	1	0	5,436
		82	1,181	19,700	1,067	16	146	0	149	32,208	54,549

01/01/2022 - 31/12/2022

Zyra e Prokurimit

JU PREZENTOJMË AKTIVITETET E ZHVILLUARA TË CILAT JANË TË PROCESUARA NGA ZYRA E PROKURIMIT: PUBLIKIMI I NJOFTIMIT PËR KONTRATË ANULIMET PËR ARSYE TË TEJKALIMIT TË VLERËS SË PLANIFIKUAR DHE TË MOS MARRJËS PJESË/ KONKURENCË TË OPERATORËVE EKONOMIK DERI TË NËSHKRIMI I KONTRATËS:

*1. PLANI I PROKURIMIT PËR VITIN BUXHETOR 2022 PËRMBAN -98 AKTIVITETE TË PROKURIMIT.

*2. NUMRI I AKTIVITETEVE TË INICUARA DERI ME 30 QERSHOR 2022 ËSHTË- 35 AKTIVITETE.

*3. NUMRI I AKTIVITETEVE TË INICUARA DERI ME 30 QERSHOR 2022 ME PLAN TE PROKURIMIT ËSHTË- 27.

*4. NUMRI I AKTIVITETEVE TË INICUARA QË NUK JANË NË PLAN TË PROKURIMIT ËSHTË -8.

*5. REALIZIMI I PLANIT TË PROKURIMIT DERI ME 31.12.2022 ËSHTË MBI -36%

*6. NUMRI I AKTIVITETEVE TË PUBLIKUARA SIPAS KËRKESAVE TË NJËSIVE TË KËRKESËS DERI ME 20.12.2022 PËR TË GJITHA LLOJET DHE VLERAT E KONTRATAVE JANË 111 AKTIVITETE, KU NË KUADËR TE KËTYRE AKTIVITETEVE JANË TE PUBLIKUARA EDHE LOLOT SIPAS NATYRËS SË AKTIVITETEVE.

*7. NE OSHP JANË DY (2) AKTIVITETE TË PROKURIMIT:

“HARTIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE” AUTORITETI KONTRAKTUES KA PRANUAR VENDIMIN ME DATË 28.12.2022, NDËRSA PËR AKTIVITETIN “

“NDËRTIMI I MURIT RRETHUES DEMUSH MAVRAJ” KA PRANUAR VETËM EKSPERTIZËN NGA EKSPERTI I OSHP-SË.

*8. AKTIVITETET E PUBLIKUARA NGA ZYRA E PROKURIMIT TEJKALOJNË NUMRIN E AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA ME PLANIN E PROKURIMIT, NGA FAKTI SE DISA NGA ATO KANË QENË PROJEKTE REZERVË DHE PROJEKTE TJERA ME BASHKËFINANCIM.

*9. NJËSIA E PROKURIMIT KA PËRMBUSHUR NË TERËSI DETYRAT ME PËRGJEGJËSI TË CILAT I KA PARAPARË LEGJISLACIONI PËRKATËS, PRA LPP-JA RREGULLORJA P.P. UDHËZIMI OPERATIV I PP DHE LEGJISLACIONI DYTËSOR

NJËSIA E PROKURIMIT NË FUND TE VITIT DO TA DHE KA OBLIGIM QE TA PLOTËSOJË DHE DERGOJ "RAPORTIN E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA PUBLIKE" I CILI PËRMBAN DATËN E INICIMIT, VLERËN E PLANIFIKUAR, VLERËN E KONTRAKTUAR DHE VLERËN E REALIZUAR I CILI DUHET TË DËRGOHET DERI ME 25-26.01.2023 NË KRPP .

SEKTORI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE KOMUNITETE

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së është formuar Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete si mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, i cili funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuar.

Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat e Zyrtares kundër Diskriminimit dhe
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rintegrim.

Duke u bazuar në planin e punës së sektorit për vitin 2022 ndër punë tjera për këtë vit janë shënuar këto aktivitete të cilat kishin si qëllim vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat e tyre. Shënimi i 8 Marsit "Dita Ndërkombëtare e Gruas" , tryeza më temën " Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave".

Fillimisht është mbajtur një tryezë me këtë temë : " Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave", darka për pjesëmarrëset dhe pastaj një manifestim.

Pjesëmarrëse në këtë organizim ishin të gjitha nëpunëset e komunës, përfshirë stafin politik dhe përfaqësues nga OSBE.

Tryezë më temën "Analiza dhe vlerësimi i kostos financiare për subvencionimin e pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetushqyese, përfituese të skemave sociale" në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsimit. Qëllimi i këtij takimi ishte të bëhet një analizë dhe vlerësim i kostos financiare lidhur me subvencionimin e pagesës për nënat vetushqyese, përfituese të skemave sociale për fëmijët që janë në kopshte, vetëdijësimi i nënave, subvencionimi dhe lirimi nga pagesa për kopshtet e fëmijëve. Pjesë e këtij takimi përveç zyrtarëve përkatës nga Drejtoria e Arsimit ishin dhe drejtoreshat e çerdheve të cilat na ndihmuan lidhur me të dhënat nga kopshtet. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës dhe Shoqatën "Handikos" u shënua edhe 21 Marsi "Dita Botërore e Sindromës Daun", ky aktivitet u shënua më mbjelljen e 21 luleve nga personat me Sindromën Daun, në oborrin Handikosit.

Pas aktivitetit diskutuam lidhur me sfidat e tyre. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi ka organizuar një tryezë me temën: "E drejta në trashëgimi dhe pronë", më qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijësimit të grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Pjesëmarrëse në këtë tryezë ishin përfaqësues nga komuna, gra nga lokacione të ndryshme, po ashtu edhe përfaqësues nga OSBE. Më këtë rast u shpërndanë edhe materiale, fletushka sa i përket të drejtës në trashëgimi dhe pronë. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim për nder të 1 Qershorit "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve" në të gjitha kopshtet e fëmijëve u shpërndan disa dhurata simbolike për fëmijët. Gjithashtu në Sallën e Kuvendit Komunal të Istogut kryesuar nga Kryesuesi i Kuvendit Enver Rugova, u mirëpritën fëmije të shkollave fillore për vizitë. SDNJK në bashkëpunim me OJQ "Vision 02" ka shënuar 24 Qershorin- "Dita Ndërkombëtare e Egjiptianëve të Ballkanit", më një sërë aktiviteteve të ndryshme, trajnime, aktivitete kulturore e sportive. Sektori për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me OJQ "Medika Gjakova", organizoi tryezë më temën: "De-Stigmatizimi dhe qasja sensitive ndaj të mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë luftës në Kosovë". Qëllimi ishte bashkëbisedimi mes akterëve komponent lokal dhe përfaqësues nga shoqëria civile mbi qasjen sensitive ndaj të mbijetuarve të dhunës seksuale që ka ndodhë në Kosovë dhe vetëdijësimi lidhur me të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi ka organizuar fushata ndërgjegjësuere më rastin e shënimit të Muajit Tetor, Muajit Rozë, muaji kundër kancerit të gjirit. Hapja e fushatës është bërë nga kryetari i cili premtoi së QKMF-ISTOG së shpejti do të pajiset me Mamograf. Fushatat ndërgjegjësuere kundër kancerit të gjirit janë mbajtur në Vrellë, Gurrakoc dhe Rakosh. Qëllimi i fushatave ishte ndërgjegjësimi i grave për parandalim, trajtim dhe kujdesin që duhet treguar për këtë sëmundje. Me rastin e shënimit të 15 Tetorit-"Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë", Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me "Shoqatën e të Verbërve", në Istog organizoi tryezë më temën: "Sfidat e personave të verbër dhe realizimi i të drejtave të tyre". Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi ka organizuar tryezë me gra më temën: "Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural".

Qëllimi i kësaj tryezë ishte informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programi për bujqësi në nivel lokal dhe qendror. Sfidat që po kalojnë gratë gjatë përgjatë ngritjes së tyre në biznes. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me OJQ "Qendra Rinore" në Istog, ka organizuar promovimin e gatimeve tradicionale në vazhdimësi të takimit lidhur me mundësitë e përfitimit të grave nga programi për bujqësi. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me Shoqatën e Handikosit më qëllim të shënimit të 3-Dhjetorit, "Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar", organizoi tryezë me qëllim të mbështetjes së këtyre personave, diskutimit të përbashkët të kërkesave dhe nevojave të tyre, mbrojtjen e të drejtave të tyre, sfidat dhe vështirësitë që kanë ata në jetën e përditshme, ofrimi i qasjes. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete ka shpall thirrje publike për organizimin dhe mbajtjen e 16 ditë aktivitetesh kundër dhunës në familje konkretisht kundër dhunës në baza gjinore. Përfituese e këtij projekti ishte OJQ "Melissa". Kjo fushatë ka filluar më 25 Nëntor në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe përfundon me 10 Dhjetor ku edhe shënohet Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Fushata "16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjinore" kishte si qëllim ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e qytetarëve në përgjithësi për dukurinë e dhunës, parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave si dhe gjatë këtyre fushatave është bërë edhe shpërndarja e fletushkave dhe bluzave me mbishkrimin "Stop Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuere janë realizuar në Shkollat, Qendrën për Punë Sociale, Qendrën e Mjekësisë Familjare, gra dhe vajza nga biznese të ndryshme dhe tek qytetarët në përgjithësi. Në kuadër të fushatës "16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza Gjinore" u mbajt edhe tryeza përmbyllëse me ligjëruesen znj. Ardita Balaj, drejtoreshë e Qendrës për Mirëqenien e Gruas në Pejë, e cila ka një përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me OJQ "Creative Youth Group" organizoi tryezë me rastin e shënimit të 10 - Dhjetorit, "Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut", me qëllim të diskutimit të përbashkët lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe aktivitetet të cilat janë realizuar përgjatë vitit 2022, nga Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete. Janë monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal, dëgjimeve me qytetarë, mbledhjet e KPF-së dhe takime tjera në kuadër të komunës.

Pjesëmarrje në tryeza diskutimit dhe trajnime të ndryshme:

1. Tryezë diskutimi me temën "E drejta e qytetarëve për qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas", organizuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, me mbështetjen të GIZ.
2. Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS) organizoi punëtorinë dy ditore rreth procesit të buxhetimit komunal.
3. Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, organizoi punëtorinë dy-ditore për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim dhe koordinim si dhe mbështetje të organizatës "Terre des Hommes", ju fton që të merrni pjesë në punëtorinë e parë regjionale, me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të Fëmijës nr. 06/L-084, duke diskutuar së bashku obligimet e komunave sa i përket zbatimit të ligjit në fjalë.
5. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) organizoi punëtorinë dy ditore me temën: "Mbështetja e Zyrtarëve Komunal për Barazi Gjinore në

sigurimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe adresimin efektiv të rasteve të dhunës në familje”.

6. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) organizoi punëtorinë për qasjen e gruas në të drejtën pronësore.

7. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) organizoi tryezë të rrumbullakët lidhur me të drejtat arsimore të komunitetit rom dhe egjiptian në Fshatin Serbobran.

8. Zyra e Kryeministrit organizoi konferencën lidhur me Zbatimin e Ligjit NR.05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi.

9. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) organizoi punëtorinë dy ditore me temën: “Mbështetja e Zyrtarëve Komunal për Barazi Gjinore në sigurimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe adresimin efektiv të rasteve të dhunës në familje”.

10. Organizata Joqeveritare Vision 02 organizoi trajnim dy ditor me temën: “Ç’është Avokimi” si dhe “Avokimi për ndryshime”.

11. Zyra për Qeverisje të Mirë organizoi "Sesion informues lidhur me Kornizën e Indikatorëve për Mbrojtjen nga Diskriminimi".

12. Qendra për Mirëqenien e Gruas organizoi trajnim me temën “ Shërbimet Sociale dhe Legjislacioni”

13. Zyra për Qeverisje të Mirë organizoi Punëtori tre ditore për hartimin e Draft- Raportit për Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi

14. Trajnim me temën “Planifikimi, raportimi dhe vlerësimi i performances së komunave” në fushën “Barazia gjinore”.

15. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim dhe koordinim, si dhe me mbështetje financiare nga Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), organizon trajnim me zyrtarë për barazi gjinore në komuna

16. Zyra e Kryeministrit organizoi konferencën “Sfidat për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe rëndësia e fuqizimit të mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi në nivel qendror dhe lokal”,

17. Qendra e Mirëqenies së Gruas organizoi trajnimin me temën : Menaxhimi emocional.

18. Zyra për Qeverisje të Mirë organizoi punëtori për monitorimin dhe vlerësimin e PKBGJ-së.

19. Institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar tryezë me temën “Sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi”.

DREJTORIA PËR INSPEKSION RAPORT PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2022

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2022, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale. Sikurse edhe gjatë vitit paraprak, përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e

ndërtimit (me 2 pozita inspektorale), sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), sektorin e veterinarisë (1 pozitë) dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë – e mbuluar përmes kontratës mbi veprën)

Gjatë periudhës raportuese, si rezultat i aktiviteteve inspektuese të realizuara në vazhdimësi në terren, janë arritur rezultate konkrete në mbikqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë, siç është prezantuar në të dhënat vijuese, e që kanë të bëjnë me:

1. Ruajtjen e brezit mbrojtës të rrugëve regjionale dhe lokale, në territorin e Komunës me ç’rast janë:

- hartuar 145 procesverbale.
- janë lëshuar 14 aktvendime .
- 15 rrethime të objekteve me shirit.
- 37 ri- inspektime
- 1 pezullim i lejes së ndërtimit.
- 12 përgjigje në bazë të kërkesës së palës.
- 8 gjoba mandatare.
- 1 rrënim – vetëdistancim.

2.Punët e Inspektorit të Ndërtimit - Zona Urbane

Punët e Inspektorit të Ndërtimit për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës Janar–Dhjetor 2022 të Zyrës së Inspeksionit dhe planit operacional të hartuar nga bartësi i pozitës.

Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të kompetencave të akteve ligjore në fuqi për pozitën e punës së lartëshënuar dhe ka qenë i fokusuar në:

➤ Inspektime për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të Ligjit Ndërtimit

Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndërtimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale, kontrollimi, evidentimi , inçizimi dhe ndërmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndjekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike.

Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veçantë në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste.

Ku gjatë këtyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane, Istog, Gurraok, Banjë dhe Vrellë janë bërë 46 inspektime dhe 72 riinspektime, 92 procesverbale , 22 aktvendime, 5 gjoba mandatare.

Me aktvendim u është ndërprerë puna 18 objekteve të ndërtimit dhe atë:

Istog -9

Banjë -5

Gurraok -4

Kemi pranuar 41 kërkesa nga investitorët dhe punëkryesit e punimeve të objekteve për të bërë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndërtimit siç parashihet me ligj të ndërtimit. Njoftim për Policinë e Kosovës, stacioni policor në Istog për asistencë në ndërprerjen e punimeve për 2 objekte. Po ashtu me 2 kërkesa u jam drejtuar: Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi për dalje të gjeodetëve në teren për inqizim të objekteve. Aktvendime për rrënimin e objekteve egzistuese për shkak të rrezikshmërisë nga shembja. Mbikëqyrjen e fushës së tregtimit, qarkullimit dhe ekspozimit të mallrave, dhe të shërbimeve, si dhe ligjshmërisë së funksionimit të veprimtarive të tilla biznesore janë zhvilluar këto aktivitete:

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë hartuar 106 procesverbale.

Janë hartuar 18 procesverbale lidhur me plotësimin e kushteve higjieniko-sanitare dhe kushteve tjera minimale-teknike për subjektet afariste të cilat kanë filluar apo vazhduar aktivitetin e tyre afarist

Janë lëshuar 18 aktvendime për plotësimin e kushteve të lartcekura dhe është dhënë pëlqimi për ushtrimin e aktivitetit afarist.

Janë hartuar 14 procesverbale gjatë kontrolleve rutinore inspektuese nëpër marketet dhe supermarketet e shitjes të mallrave me pakicë. Inspektime këto që kanë të bëjnë me dukurinë e rritjes së çmimeve për artikujt ushqimor sic janë vaji , vezët , sheqeri.

Janë hartuar 2 procesverbale lidhur me ankesën e konsumatorëve ndaj operatorëve ekonomik.

Janë hartuar 9 procesverbale gjatë inspektimeve të jashtëzakonshme në mbështetje nga Policia e Kosovës, inspektime këto që kanë të bëjnë me mosrespektimin e orarit të punës nga subjektet afariste.

- Janë hartuar 16 procesverbale lidhur me shitjen ambulanore në rrugë dhe trotuare.
- Janë hartuar 13 procesverbale me rastin e inspektimit të furrave të bukës.
- Janë hartuar 5 procesverbale me ç'rast është bërë konfiskimi i disqeve për prerjen e metalit, disqe këto të cilat kanë qenë me afatat të skaduar.
- Janë hartuar 14 procesverbale lidhur me mosrespektimin e vendimit të Ministrisë së Industrisë , Ndërmarrësisë dhe Tregtsë për çmimin maksimal të lejuar për secilin produkt të naftës.

- Janë lëshuar 2 gjoba mandatare.
- Janë lëshuar 8 aktvendime për shqiptimin e gjobave.
- Është hartuar 1 procesverbal në shtëpinë e pleqëve në Istog
- Është hartuar 1 procesverbal për konstatimin e moszhvillimit të aktivitetit afarist të subjektit ekonomik.
- Janë hartuar 5 procesverbale lidhur me aktivitetin afarist në gastronomi - motele.
- Janë hartuar 5 procesverbale në bashkpunim me AUK-në dhe IKSHP-në për marrjen e mostrave sanitare dhe ushqimore.
- Janë hartuar 2 procesverbale në bashkpunim me Hidrodrinin lidhur me keqpërdorimin e ujit të pijes.
- Është hartuar 1 procesverbal lidhur me mbylljen e lokalit për tekalinimin e orarit të punës.
- Është lëshuar 1 aktvendim për mbyllje të lokalit.
- 1 Fletëparaqitje në Gjykatë lidhur me mos vendosjen e çmimevetë naftës dhe nënprodukteve të naftës.

Si dhe shumë aktivitete rutimore të përditshme të shoqëruara me vërejtje gojore .

4. Në sektorin e mbrojtjes së mjedisit - ambientit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë hartuar 11 procesverbale inspektuese .
- Janë shqyrtuar 5 kërkesa të palëve të cilat kanë marrë zgjidhje.
- 4 shkresa drejtuar palëve dhe institucioneve të ndryshme.
- 4 lëndë janë në procedure.

Vlenë për tu cekur se për shkak të mungesës së Inspektorit të mjedisit aktivitetet në këtë sektor janë kryer me autorizim nga zyrtarja për ambient.

5.Sektorin e veterinarisë: Gjatë periudhes raportuese inspektori i veterinarisë në bazë të ligjeve respektive në fuqi ka zhvilluar këto aktivitete :

- Aktivitetet lidhur me therjen, shitjen dhe qarkullimin e mishit; me ç' rast janë realizuar 376 vizita-inspektime të therjes dhe vulosjes së mishit.
- 2 Inspektime të hurdhave të peshkut.
- 6 Procesverbale me rastin e semundjes dhe ngordhjes të kafshëve dhe shpezëve.
- 6 Procesverbale të hartuara si pasojë e dëmtimit dhe mbytjes së kafshëve nga ujku, ariu dhe procesverbalet e hartuara me kërkesën e palës.

- 5 Inspektime të mishit dhe produkteve të mishit në markete dhe qendra tregtare.

6. Në sektorin e komunikacionit:

Në bazë të kompetencave të lartcekura Inspektori i autorizuar Komunikacionit ka paraqitur këtë raport të aktiviteteve të kryera .

31 Inspektime të operatorëve ekonomik të transportit publik të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Istogut.

52 Inspektime të operatorëve të transportit me auto-taxi në territorin e komunës së Istogut.

Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën Janar – Dhjetor 2022, kësaj Drejtorie i janë parashtruar 101 kërkesa nga ana e qytetarëve dhe bizneseve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në terren nga të cilat 71 janë miratuar , 13 janë pezulluar, 13 janë në proces, 3 janë hedhur poshtë dhe 1 është ceduar .

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA **RAPORTI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2022**

Korniza Afatmesme Buxhetore(KAB) Për vitin 2023/2025 është dorëzuar në fund të shtatorit/2022 në Thesarin Qendror-MEF. Plani i të hyrave për Komunën dhe plani i shpenzimeve të Komunës për vitet 2023-2025. Të hyrat vetanake janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale mbi të Hyrat, në të cilën janë determinuar cilat të hyra ka të drejtë t'i arkëtojë komuna si: tatimi në pronë, taksat për dhënie e lejeve të ndërtimit, taksat nga licencat e lokaleve, taksat e shërbimeve komunale si dhe të hyrat nga dënimet e shqiptuara, në komunikacion etj. Dhënia e shënimeve të përditshme mbi buxhetin dhe shpenzimet buxhetore nga "FreeBalance" Në vijim po paraqesim burimet e financimit të Buxhetit për vitin 2022 dhe mjetet e bartura 2019 në vitin 2020 dhe realizmi i shpenzimeve prej 01.01.2022 gjerë më 31.12.2022.

BURIMET E FINANCIMIT PËR VITIN 2020	PLANI I BUXHETIT 2020	SHPENZIMET BUXHETORE 2020	SHPENZIMET BUXHETORE TË REALIZUARA NË %
1			
10.GRANTI QEVERITAR 2020	10,532,882.29	10,498,597.64	94.27%

21.TE HYRAT VETANAKE 2020	1,160,615.00	945,930.54	81.50%
22.MJETET E BARTURA NGA VITI 2019 NE 2020	777,217.70	617,006.37	79.39 %
31.MJETE BUXHETORE NGA DONATORET E MBRENSHEM	46,164.32	31,495.00	68.22%
04.FINANCIMET NGA HUAMARRJET	144,806.00	0	0.0%
73. USAID	3.18	0.00	0,00%
93.COUNCIL OF EUROPE	520.00	0.00	0,00%
TOTAL: BUXHETI PËR VITIN 2022	12,760,810.78	12,726,526.13	91.07%

Shënim: Në Tabelen e mësipërme janë paraqitur të dhënat nga Raportet SIMFK FreeBalance të datës 30.12.2022. Nga shifrat nga tabela shihet trendi i mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara nga buxheti qendror dhe të hyrat vetanake nga niveli lokal 2022 dhe të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2019 në vitin 2012 , për këtë periudhë raportuese. Trendi i shpenzimeve dhe përcaktimi i tyre varet kryesisht nga trendi i të hyrave vetanake të arkëtuara të cilat janë kontribut i qytetarëve nga tatimi dhe taksat e ndryshme komunale nga të cilat varet realizimi projekteve parësore të komunës të cilat projekte kryesisht janë në të mirën e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe standardin jetësor .

Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2022 janë në shumë prej 1,160,615.00 €. Deri me 31.12.2022 janë mbledhur (arketuar) të Hyra Vetanake Komunale në shumën prej 1,375,299.46 € në përqindje i bie 118% %. Janë kryer këto punë dhe detyra të punës: Përpunimi i të Hyrave Komunale dhe ndarja sipas Kodeve ekonomike, Regjistrimi i të Hyrave vetanake në sistemin FreeBalance, Përcjellja e arkëtimit të të Hyrave Vetanake Komunale, Kërkesat për Alokimin e të Hyrave Komunale në Thesarin Qendror, Barazimi i të Hyrave Komunale me Thesarin Qendror, Raportet mujore,tremujore dhe gjashtëmujore i të Hyrave Komunale dhe barazimi i tyre, Barazimi dhe menaxhimi i të Hyrave vetanake Komunale sipas Planit vjetor të Aprovuar .

Janë kryer këto punë dhe detyra të punës nga Zotimet e Organizatës Buxhetore- Komuna e Istogut. Janë bërë regjistrimet e zotim/ obligimeve dhe kërkesave të zotuar rreth 4598 lëndë OUP dhe Kërkesa Zotim për Blerje, lëndëve në sistemin e "FreeBalance". Punët e kryera për Zotimet e lëndëve: Regjistrimi i zotim/obligimeve në sistemin FreeBalance për Programet Buxhetore të Komunës, Punët profesionale, administrative dhe nxjerrja e raporteve për pozitën financiare të Komunës nga Thesari-FreeBalance, Punët mbi sigurimin-kontrollin e nënshkrimeve të zyrtarëve përkatës në formularin UOP (CPO), KZB-Kerkesave Zotim për Blerje, Konsultimet me Zyrën e Prokurimit dhe dorëzimi i Urdher Obligimeve UOP (CPO) dhe KZB-Kerkesave Zotim për Blerje në Zyrën e Prokurimit për procedim të procedurave. Shpenzimet gjatë periudhës 01.01.2022 deri 31.12.2022 janë kryer të gjitha lëndët dhe kanë ardhur për procesim. Është bërë procesimi dhe futja në sistem 5,436 lëndëve në sistemin SIMFK-FreeBalance, (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) Rimbushje Petty Cash-Para të Imëta 1 lëndë, 1 Mbyllje të Avanseve për Petty Cash- Para të Imëta dhe është bërë pranimi i të gjitha lëndëve nga Zyrtarët e Pranimit dhe Zyrtarët tjerë që janë në lidhmëri me procesin e shpenzimeve nga Buxheti Komunal. Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit pa Urdhër Blerje (UOP) dhe verifikimi i furnitorëve dhe llogarive bankare të të gjithë operatoreve ekonomik. Regjistrimi i Kuponave të shpenzimeve me Urdhër Blerje që rrjedhin nga procesi i prokurimit (Lëndët që kanë të bëjnë me procesin e prokurimit), Regjistrimi i Kuponave të shpenzimeve të Parave të Imëta (Rimbushja e Parave të imëta- Petty Cash-it) dhe Mbyllja e Avanseve për Petty Cash sipas procedurave të Thesarit Regjistrimit i Kuponave të Shpenzimit për Shpenzimet dhe Paraja e vogël (xhepi) për udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Pasuritë, Regjistrimi i pasurisë Gjatë periudhës 01.01.2022 deri 31.12.2022 janë kryer këto punë dhe detyra të punës, të gjitha lëndët të cilat kanë përfunduar procesimin e pagesave në shumat totale. Pritet të bëhet procesimi dhe futja në sistem e lëndëve të Projekteve Kapitale që kanë përfunduar dhe kanë qenë për procesim nga Ministrit e Linjës për vitin 2022.

SEKTORI I FINANCIVE

Sektori i Financave gjatë kësaj periudhe ka kryer punë në harmoni me planin e punës si dhe punë tjera të cilat janë caktuar nga ana e eprorit. Janë pranuar gjithsej 7856 lëndë nga ana e zyrtarit për shpenzime të cilat janë kontrolluar, certifikuar dhe janë aprovuar përmes sistemit të Fribalancit pasi që kompetencat kanë kalu nëpër Komuna. Gjatë kontrollës si lëndë të pa kompletura dhe që janë kthyer tek personat përgjegjës për tu kompletuar janë 36 lëndë. Të gjitha këto lëndë janë regjistru në një program të exellit për evidencë dhe të njëjtat lëndë janë dorëzuar tek zyrtarja për arkivim të lëndëve.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Sektori i Tatimit në Pronë funksionon në kuader të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, pranë Komunës së Istogut.

Ne kuadër të punëve dhe detyrave të punës gjatë periudhës prej 01.01.2022 deri me 31.12.2022, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- **Lëshuarja e faturave tatimore për vitin 2022** – për këtë vit kalendarik janë lëshuar gjithësejt 33.563 fatura, ato janë:

- **11.349 fatura per objekte të palujtshme**, per këto kategori: objekte banimi, afarizmi, industriale dhe bujqësore;

- **22.214 fatura per parcella**, për këto kategori: parcella për shtëpi familjare, bujqësore, afariste, industriale dhe pyjore.

Aplikimi i tatimit në pasuri te palujtshme - parcela, ka filluar nga viti 2019 per të gjitha parcellat e cekura më lartë, përveç atyre bujqesore.

- **Shuma e faturuar** - për këtë vit tatimor shuma e faturuar gjithësejt është 538.935 €, prej tyre 393.857 € janë për objekte, kurse 145.078 € janë për parcella.
- **Planifikimi i inkasimit:** Sipas të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2022 është paraparë që të inkasohen nga taksat mbi prona një shumë prej 397,000 €, prej të cilave 391,341 € nga objektet dhe 5,659 € nga parcelat.
- **Shpërndarja e faturave:** Faturat tatimore për të gjithë tatimpaguesit e tatimit mbi prona shpërndahen përmes Postës së Kosovës në Njesinë në Istog. Nga numri i përgjithshëm i faturave, shpërndarja bëhet vetëm për faturat që kanë ngarkesë tatimore mbi 3 €, sipas Ligjit në fuqi.

Sipas Raportit mbi pranim-dorëzimin e dërgesave të faturave të tatimit mbi pronë për këtë vit, i datës 09.06.2022 nga PK-Njesia në Istog, gjendja e shpërndarjes së faturave është si vijon:

Nr.faturave	Shpërndarja	Mbetja	Përqindja
9.476	9.226	250	97,36 %

Mbetja prej 250 faturave të pa shpërndara është si rezultat i ndryshimit të vendbanimit nga tatimpaguesit, si dhe adresave jo të sakta, sipas arsyetimit të PK.

Në lidhje me ndërhyrjet në sistemin e tatimit mbi pronë, sipas shënimeve të mbledhura në terren dhe në zyrë, për këtë vit janë kryer këto ndërhyrje në sistemin e tatimit mbi pronë:

Regjistrimi i 533 objekteve të reja,

Modifikimi/rianketimi i të dhënave të pronës në 5,445 raste, duke tejkaluar kuotën prej 20%.

- 2.528 modifikimi i të dhënave të tatimpaguesit.

Ankesat - Gjatë afatit të parashtrimit të ankesave, për këtë vit janë pranuar gjithsej 7 ankesa me shkrim nga tatimpaguesit. Komisioni për verifikim të ankesave ka kryer verifikimin në teren për çdo rast. Të gjitha ankesat e tatimpaguesve janë aprovuar. Janë punuar vendimet me shkrim dhe është kryer ndërhyrja në sistemin e tatimit mbi pronë për korigjimin e ngarkesave tatimore për rastet e aprovuara.

Vertetimet - Gjatë punës me palë, gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar rreth 5,983 vertetime nga sistemi i tatimit mbi pronë, me kërkesë të palëve, të cilat shërbejnë për nevoja personale si: transferim pronash, aplikim për tender, aplikim për subvencione nga bujqësia, aplikim për ndihma sociale etj.

Inkasimi - Gjatë këtij viti, inkasimi i tatimit mbi pronë sipas muajve, dhe krahasimi me vitin e kaluar, është si vijon:

MUAJI	Viti 2021 ne €	Viti 2022 ne €
Janar	26.283,51	12.686,69
Shkurt	58.392,98	17.491,68
Mars	46.982,49	67.011,74
Prill	47.614,44	42.906,78
Maj	37.216,87	54.473,10
Qershor	40.034,82	19.519,70
Korrik	39.511,00	39.946,30
Gusht	72.260,49	65.945,08
Shtator	44.372,50	22.068,75
Tetor	24.102,59	23.386,08
Nentor	13.232,05	17.344,47
Dhjetor	24.057,78	27.741,57
Gjithsej	410.521,94 ose 104%	474.061,52 ose 109 %

Sipas Planifikimit për të Hyrat Vetanake Komunale, në emër të tatimit në pronë për vitin 2022, janë planifikuar të inkasohen 397,000,00 €. Të inkasuara deri në ditën e raportimit, më 31.12.2022 janë 474,061.52 € ose 109% në raport me planifikimin.

Me qëllim të inkasimit të borxheve të tatimit në pronë, gjatë vitit janë përgatitur dhe shpërndarë:

293 Letër-kujtesa,

17 Kontrata për pagesë me këste të detyrimeve të tatimit në pronë dhe

18 Vërejtje përfundimtare.

PROJEKTET KAPITALE TË REALIZUARA NË BUXHET DHE FINANCA GJATË VITIT 2022

21- TE HYRAT VETANAKE 2020

50240 PROJEKTI ME PARTICIPIM TE KOMUNITETETIT ,MINISTRIVE TE LINJE	173,591.50	173,591.50
50241 PARTICIPIM PËR PROJEKTET E IPA FONDIT	60,000.00	60,000.00
50242 PARTICIPIM PËR PROJEKTET PE EFIÇENCË TË ENERGJISË	20,000.00	20,000.00

31- PARTICIPIMI I QYTETARËVE

52269 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATRAT E KOMUNES SE ISTOGUT	116,408.50	116,408.50
53916 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN OSMANAJ NE PREKALLE DHE NE LAGJ	10,000.00	10,000.00

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK RAPORTI GJASHTË MUJOR PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2022

Në këtë periudhë, personeli i sektorit të ekonomisë është angazhuar në një sërë punësh dhe detyrash. Këto përfshijnë organizimin dhe koordinimin e punëve të sektorit për ekonomi me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë, përgatitjen e listës së borxheve për ngarkesat vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrje hoteliere, si dhe përgatitjen dhe lëshimin e faturave për këto ngarkesa vjetore. Gjatë këtij viti, janë inkasuar 1280,00 euro nga ngarkesat vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike.

Personeli gjithashtu ka punuar në përgatitjen e dokumentacionit për zotimin e mjeteve dhe kompletimin e lëndëve për procedimin e pagesave për projektet kapitale të Drejtoratit

Ekonomi dhe Zhvillim të planifikuara për vitin 2022. Ata gjithashtu janë angazhuar në procesimin e kërkesave të palëve dhe në disa raste kanë qenë pjesë e komisioneve për vlerësimin e ofertave të projekteve kapitale.

Në Qendren Komunale të Bizneseve janë kryer shumë punë, duke përfshirë:

Regjistrim i bizneseve-----	165
- Shuarje të bizneseve -----	15
- Ndryshime në biznes -----	123
- Informata të biznesit -----	73
- Vërtetim biznesi -----	8
- Çertifikata të reja (NUI) -----	265
- Këshillime për regjistrim të bizneseve -----	276
- Këshillime për ndryshime në biznes -----	146
- Këshillime për shuarje të biznesit -----	42
- Certifikata duplikat -----	05

Duhet të theksohet se regjistrimi i bizneseve bëhet pa pagesë (taksa) me vendim të MTI-së, por taksat tjera ende aplikohen për ndryshimet në biznes, shtimin e aktiviteteve, ndërrimin e llogos, etj. Personeli ka mbledhur informacione rreth aktivitetit ekonomik të bizneseve, ka vizituar këto biznese, dhe ka ndihmuar dhe informuar për regjistrimin dhe ndryshimet në bizneset e tyre. Mbledhja, përpunimi i shënimeve dhe dërgimi i tyre në Ministrinë përkatëse, plotësimi i formularëve dhe pyetësorëve me shënimet e kërkuara. Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare, si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, gjegjësisht Sektorit për Ekonomi.

Sektori i zhvillimit

Tabela e projekteve kapitale të cilat janë në procedurë e sipër për periudhën Janar - Dhjetor 2020

Nr. Ren.	Emërtimi i projektit	shuma e planifikuar	shuma e kontraktuar	burimet e financimit	vërejtje
1	46288 NDËRTIMI I RRUGËVE NË GURRAKOC	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
2	46291 NDËRTIMI I RRUGËVE NË VRELLË	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
3	48879 NDERTIMI I RRUGEVE NE BANJE	40,000.00	40,000.00	buxheti komunal	perfunduar
4	48881 NDERTIMI I RRUGEVE NE ISTOG	40,000.00	40,000.00	buxheti komunal	perfunduar
5	50385 NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NE KALIQAN:UKAJ, METAJ	20,000.00	20,000.00	buxheti komunal	perfunduar

6	50407 NDËRTIMI I RRUGËVE "XHEME AVDYLAJ"&"SELIM BRAHIMI" NE SHUSHI	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
7	50901 NDËRTIMI I RRUGËS "SELIM BRAHIMAJ" SHUSHICË	13,000.00	13,000.00	buxheti komunal	perfunduar
8	50911 NDËRTIMI I RRUGËVE "FUSHË KUQE"DHE "MOLLA E KUQE" NË KOVRAGË	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
9	51048 ASFALTIMI I RRUGËS ? REGJË KASTRATI? NE KASHICË	25,000.00	25,000.00	buxheti komunal	perfunduar
10	52234 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN "HAKAJ"-ORROBERDE	20,000.00	20,000.00	buxheti komunal	perfunduar
11	52235 NDERTIMI I RRUGES NE "CERKOLEZ"	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
12	52236 NDERTIMI I RRUGEVE NE TRUBOHOC LAGJ CETA BAJR.OSMANAJ	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
13	52237 NDERTIMI I RRUGES "TAHIR SYLAJ" NE CARALLUKE	6,000.00	6,000.00	buxheti komunal	projekt me huamarrje
14	52238 NDERTIMI I RRUGES"LAGJA REXHAJ DHE HASKAJ" NE CERRCE	40,000.00	40,000.00	buxheti komunal	perfunduar
15	52239 NDERTIMI I RRUGES "SYLE DRESHAJ" NE VRELLE	60,000.00	60,000.00	buxheti komunal	perfunduar
16	52240 NDERT.RR.LUBOZH."LAGJ LAJQI, IDRIZAJ,LAHAJ DHE PEPAJ"	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	projekt dy vjeçar
17	52241 ND.RRUG."AHMET CANI" NE LAGJEN IMERJA NE LLUGA	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar
18	52242 NDERTIMI I RRUGES "SHPEND KUKIQI" NE PADALISHTJE	30,000.00	30,000.00	buxheti komunal	perfunduar


19	52243 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATIN KERNINE E EPERME DHE E ULET	40,000.00	40,000.00	buxheti komunal	perfunduar
20	52244 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN "MAHAJ"NE DUBOVE TE VOGEL	15,000.00	15,000.00	buxheti komunal	perfunduar
21	52245 NDERTIMI I RRUGEVE NE RAKOSH LAGJA "HAXHIJAJ DHE JAHAJ"	25,645.00	25,645.00	buxheti komunal	perfunduar
22	53920 NDËRTIMI I RRUGËS"IDRIZ NEKAJ" NË SHUSHICË TË ULËT	45,000.00	45,000.00	buxheti komunal	projekt dy vjeçar
23	89977 ASFALTIMI I RRUGVE LOKALE NE SARADRAN	50,000.00	50,000.00	buxheti komunal	perfunduar
24	53921 NDËRTIMI I RRUGËS"DESHMORET SALIHAJ"NË SHUSHICË TË ULËT	13,000.00	13,000.00	buxheti komunal	perfunduar
25	53922 NDËRTIMI I RRUGËS SË VARREZAVE NË GURRAKOC	35,000.00	35,000.00	buxheti komunal	perfunduar
26	53923 NDËRTIMI I RRUGËS UNITETI NE ZALIQ	18,000.00	18,000.00	buxheti komunal	perfunduar
27	50407 NDËRTIMI I RRUGËVE "XHEME AVDYLAJ"&"SELIM BRAHIMI" NE SHUSHI	20,000.00	20,000.00	buxheti komunal	perfunduar
28	52210 NDERT.RR."REXHE DESTANI-BERATI-HASAN PRISHTINA" ISTOG I P.	60,000.00	60,000.00	buxheti komunal	perfunduar
29	52211 NDERTIMI I RRUGES NE LAGJEN "HAJRIZAJ" NE ZHAKOVE	25,034.67	25,034.67	buxheti komunal	projekt dy vjeçar

1. Janë realizuar gjithsej : 32 projekte në ndërtimin e rrugëve lokale me gjatësi prej 21.77 km gjatësi nga buxheti i komunës
2. Janë realizuar gjithsej : 2 projekte me Ministrinë e Administrimit Lokal në ndërtimin e rrugëve me gjatësi prej 3.1 km gjatësi
3. Janë realizuar gjithsej: 12 projekte në bashkëfinancim me komunitetin në ndërtimin e rrugëve lokale me gjatësi prej 2.3 km gjatësi.
4. Me kërkesën tonë janë rehabilituar 3 segmente të rrugëve rajonale, Zallq-Osojanë, me gjatësi prej 350 m si dhe Prekallë tomoc me gjatësi prej 3 km dhe Gurakoc tomoc me gjatësi prej 2.5 km si dhe Istog Vrellë me gjatësi prej 5 km është riparuar në total 10.35 km rrugë rajonale janë mirëmbajtur dhe rindërtuar me asfalt nga Ministria e Infrastrukturës.
5. Janë nënshkruar marrëveshje me ministrinë e infrastrukturës projekte në vlerë prej më shumë se 1 milion euro për vitet e ardhshme si Rruga Bajram Gashi në Istog dhe ndërtimi i Qendërs së Istogut dhe Ndërtimi i Qendërs në Gurakoc.
6. Janë ndërtuar kanale të ujëitjes me gjatësi prej 1.7 km nga drejtoria jonë.
7. Është ndërtuar zona e re ekonomike në banje të Istogut
8. Është ndërtuar ndriqim me gjatësi prej 3.5 km ndriçimi në zonen biznesore, rrugën 7 marsi në gurakoc, dhe 24 qershori në zallq.
9. Janë përkrahur gjithsej 12 biznese që udhëhiqet nga grant në bashkëpunim me fondacionin Preda Plus me pajisje sipas nevojave të veprimtarive që ato i ushtojnë.

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI
RAPORTI GJASHTË MUJOR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2022


Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi gjatë vitit 2022 ka trajtuar mbi 1700 Lëndë(Kërkesa) të natyrave të ndryshme nga qytetarët duke përfshirë: Regjistrim Pronësie, Historiate, Hipoteka, Ndarje-Bashkim Parcelash etj.

LËNDET E TRAJTUARA GJATË VITIT 2022



-Gjatë vitit 2022 kemi vazhduar me takimet me palë çdo ditë pune si në sektorin e Kadastrit ashtu edhe në atë të Gjeodezisë nga ora 08:00 deri në ora 12:00 e gjatë muajve korrik dhe gusht për shkak të rritjes së volumit të punëve nga ardhja e mërgimtarëve, në mënyrë që të jemi sa më korrekt me qytetarët takimet i kemi lejuar gjatë gjithë orarit të punës në çdo ditë pune.

Krahas këtyre në Zyren Kadastrale Komunale në Istog gjatë vitit 2022 janë lëshuar mbi 4700 Çertifikata të Pronësisë dhe mbi 2100 Kopje të Planit.



Gjatë vitit 2022 Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka realizuar mbi 110 Dalje Zyrtare në Teren të cilat kanë qenë kërkesa të Drejtorive të ndryshme Komunale të cilat matje në teren i'u kanë kontribuar këtyre drejtorive për realizimin e projekteve të ndryshme kapitale, por i'u kemi përgjigjur pozitivisht dhe në kohë edhe kërkesave të institucioneve të tjera me të cilat kemi bashkëpunuar ngushtë gjatë këtij viti si Policia e Kosovës dhe Gjykata.

Në Kuvendin e Komunës kemi procesuar disa kërkesa të fshatrave për destinimin e parcelave të ndryshme për Varreza, si dhe kemi destinuar parcela në qytet për rekreacion poashtu me vendim të Kuvendit Komunal.

-Gjatë vitit 2022 duke falënderuar për bashkëpunimin edhe AKK(Agjencia Kadastrale e Kosovës) kemi arritur që për herë të parë të fillojmë me Lëshimin e Çertifikatave të Pronës dhe Kopjeve të Planit Online duke hedhur një hap të ri drejt Digjitalizimit të shërbimeve të cilat do të vazhdojnë edhe më tutje.


Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e borxheve të vjetra të poseduesve të pronave komunale, duke i ftuar palët me shkresa zyrtare nga të cilat veprime kemi arritur ti inkasojmë mbi 4500 euro borxhe të vjetra, ndërsa palët të cilat nuk i janë përgjigjur shkresave/vërejtjeve tona, ndaj tyre kemi marrë masa konkrete duke bërë propozim përmbarimor te përmbaruesi privat nga i cili jemi në pritje të realizimit përmbarimor nga i cili do të realizojmë të hyra të tjera të rëndësishme për Komunën.

Kujtojmë që kjo pikë ka qenë e evidentuar në raportin e Auditorit të cilat rekomandime ne i kemi marrë me seriozitet dhe kemi marrë veprime nga të cilat veprime kemi arritur këto rezultate konkrete.

-Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka pasë të planifikuara t'i realizojë 80.000 të hyra vetanake për vitin 2022, nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022 ka realizuar të hyra vetanake nga

shërbimet që i'u ka ofruar qytetarëve mbi 114.500 euro që përkthyer në përqindje realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2022 ka qenë mbi 143%.

Të hyrat vetanake të realizuara



- Taksa për Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit
- Taksa për Bartje, Hipoteka dhe Lëndet Gjeodezike

-Në muajin dhjetor sipas obligimit ligjor kemi nxjerrë vendim në asamblenë Komunale dhe kemi publikuar Listën e Pronave të Përgjithshme Komunale si dhe Listën e Veçantë të Pronave që planifikohen të jepen në shfytëzim për vitin 2022.

Në Listën e Veçantë pronave kemi propozuar 54 Prona komunale me një sipërfaqe të përgjithshme rreth 600 hektarë, duke qenë kështu të pregatitur për të i'u përgjigjur pozitivisht secilit investitor serioz si i huaj apo vendor të cilët kanë për qëllim hapjen e vendeve të reja të punës dhe investime të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Istogut.

-Në aspektin e burimeve njerëzore gjatë vitit 2022 duke parë nevojën e jashtëzakonshme për staf, janë inicuar procedurat rekrutuese dhe janë plotësuar edhe 2 pozita të cilat kanë mbetur të vakante gjatë vitit 2022, ndërsa kemi planifikuar edhe 2 pozita të tjera gjatë vitit 2023 kështu duke i'u përgjigjur kërkesave të qytetarëve për shërbime të shpejta dhe efikase.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS JANAR-DHJETOR 2022

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mjedis, gjatë vitit 2022, kujdes i veçantë i është kushtuar përfundimit të lëndëve të vjetra për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë, duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim ende pa arritur zgjidhjet urbane, andaj është aprovuar zgjidhje urbane që do t'u ndihmojë kërkuarve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë II.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar përmes QSHQ gjithësej 528 lëndë në të tre Sektorë të ndryshëm. Në Sektorin e Planifikimit Urban janë rexhistruar gjithësej 355 lëndë nga më të ndryshmet. Në Sektorin e Legalizimeve janë rexhistruar 159 lëndë të të dy kategorive të ndërtimeve dhe në Sektorin e Mjedisit janë rexhistruar 14 kërkesa të profileve të ndryshme.

Sektori i Urbanizmit

Gjatë kësaj periudhe janar – dhjetor të vitit 2022, është evidentuar numër mesatar i kërkesave pamëvarësisht Pandemisë dhe Krizës globale, andaj dhe intensiteti i punës në këtë sektor ka vazhduar puna normalisht në zgjidhje të lëndëve. Janë evidentuar mbi 355 kërkesa, prej të cilave 138 kërkesa për kushte dhe leje ndërtimi. Janë trajtuar 138 kërkesa nga 138 sa janë pranuar për Kushte dhe Leje ndërtimore. Janë miratuar 106 leje ndërtimi, nga të cilat 1 ndërtesë e banimit shumëkatëshe i është vazhduar LN dhe 84 ndërtesa të banimit individual. Gjithashtu 16 ndërtesa për zhvillim ekonomik dhe 6 ndërtesa tregtare-afariste janë procesuar dhe janë pajisur me Leje ndërtimore. Sikur edhe është paraqitur në tabelë, gjatë këtij viti janë përcaktuar kushte-pelqime ndërtimi për 198 kërkesa, derisa 106 kërkesa janë përfunduar me pëlqime të ndryshme, pëlqime parimore paraprake sa i përket pronës dhe të ngjashme. Janë në procesim edhe 9 kërkesa.

Tabela 1. Lëndet e pranuar dhe të shqyrtuara nga DPUM për vitin 2022.

Koha	Leje ndërtimi	Kushte ndërtimi	Certifikatë përdorimi	Pelqime për ndërtim	Pëlqimet	Përgjigje (refuzuara)	Në proces (të bartura)
Janar	2	1		41	65	83	9

Shkurt	8	3	1				
Mars	11	4	2				
Prill	9	0					
Maj	4	0					
Qershor	9	2					
Korrik	7	1					
Gusht	9	4					
Shtator	1		2				
Tetor	26		3				
Nëntor	12	3	3				
Dhjetor	8	1	1				
Gjithsej	106	19	12	41	65	83	9

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01/22. Në të hyra kanë ndikuar edhe taksa për Shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **165.248,81 €**, nga taksa administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës. Taksë tjetër që është taksu përmes kësaj Drejtorie është edhe taksa për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore dhe atë në shumë prej **25.855,80 €**.

Gjithashtu janë realizuar **2.178,12 €** nga taksa për pajisjen me leje të rrënimit dhe certifikatë të përdorimit, pelqime dhe shërbime tjera në kuadër të DPUM.

Gjithsej, DPUM në Sektorin e Lejeve ndërtimore ka realizuar **205.213,61 €** duke mos llogaritur shërbimin për Legalizim dhe Mjedis.

Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit (Permit tracking System), ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim. Një ndër aktivitetet është vazhdimi dhe emërtimi i rrugëve, i udhëhequr nga Sektori i shërbimeve të përbashkëta, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv.

Duhet theksuar se këtë vit është krijuar dhe Zyra për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DUNMM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

- ☐ Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;
- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- ☐ Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;
- ☐ Përpunimi i faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- ☐ Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
- ☐ Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
- ☐ Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve
- ☐ Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
- ☐ Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
- ☐ Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
- ☐ Takimet me qytetarët për diskutimet për Hartën Zonale
- ☐ Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
- ☐ Përgatitja e detyrave projektuese;
- ☐ Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
- ☐ Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- ☐ Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
- ☐ Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
- ☐ Pranimi i lëndëve dedikuar vetëm për Sektorin e legalizimit;
- ☐ Fillimi i trajtimit të lëndëve të legalizimit;
- ☐ Hartimi i databazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- ☐ Fushata informuese dhe sensibilizuese;
- ☐ Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
- ☐ Legalizimi i objekteve të dy kategorive;
- ☐ Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
- ☐ Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
- ☐ Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
- ☐ Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
- ☐ Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
- ☐ Mbjellja e drurëve dekorativë;
- ☐ Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Dhjetori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitete rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPHI;

☐ Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

☐ Nënshkrimi i Memorandumit për Legalizim në mes të USAID-it.

☐ Nënshkrimi i Memorandumit për Adresa në mes Agjencionit Kadastral të Kosovës.

☒ **Realizimi i Projekteve kapitale të realizuara, siq janë:**

☒ “Rregullimi i Trotuareve në Istog (zonat urbane)” ,

☒ “Mirëmbajtja e Adresave” ,

☒ “Rregullimi i Lapidarit të Dëshmorëve në Istog”(Projekt 2 vjeçar 2022-2023),

☒ “Ndertimi i rr.Ibrahim Rugova,Fadil Ferati dhe UÇK “ (Projekt 3 vjeçar),

☒ “Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut 2022-2023-2024 (Projekt 3 vjeçar).

Legalizimi

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis në vitin 2022 ka pranuar gjithsej 159 kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje, të cilat në disa raste me një kërkesë ka tre deri në katër aplikacione për legalizim të ndërtimit, e duke llogaritur edhe 85 kërkesa të cilat nuk janë shqyrtuar të vitit 2021, në procedurë ka pas gjithsej 244 kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje prej të cilave kemi shqyrtuar dhe kemi nxjerr vendim:

1. Vendime për Legalizim – 98,
2. Vendime për listë të pritjes – 29,
4. Vendime me aplikacionet e refuzuara-2.

Kemi lëshuar 50 fletëpagesa, nga të cilat kemi inkasuar **11.972.88 €** euro nga procesi i legalizimit gjatë kësaj periudhe të vitit 2022. Ju njoftoj që jemi në shqyrtim të kërkesave të cilat ende janë në procedure, pasi që një numër të madh të tyre e kemi pranuar përmes aplikimit me postë në përfundim të afatit dhe mundësisë për aplikim, kërkesa këto të cilat mbi 50 ende nuk janë të regjistruara në sistemin e ARLPL-së, të njejtat do t'i trajtojmë dhe shqyrtojmë me efikasitet pasi që të njejtat kanë mangësi në plotësim të dokumentacionit. Sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës Nr.Br.01-527/022, të datës 25.07.2022 kemi autorizuar zyrtarin për kryerjen e detyrave të punës shtesë pa Kompensim të zyrtarit për Regjistrim të Adresave, ku gjatë kësaj periudhe kam pranuar 13 kërkesa për emërtim, ndryshim të emrave të rrugëve, kam lëshuar 184 vërtetime të adresave, dhe kemi paisur me numra të shtëpisë shumë qytetarë të cilët janë paraqitur në zyrën e drejtoratit të urbanizmit. Sipas vendimeve të kryetarit të komunës gjatë vitit 2022 Zyrtari Ligjor pranë DPUM ka qenë pjesë e grUpeve punuese si anëtar në hartimin e rregulloreve të

brëndshme Komunale: Rregullorës për Kategorizimin e Sporteve. Projekt-Rregullorës për organizimin dhe bashkpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Istogut. Anëtar i komisionit vlerësues të tenderit me numër të jashtëm të prokurimit 633-022-8391-1-2-1, dhe me numër të brendshëm të prokurimit 633-022-046-121. Anëtar i komisionit për shqyrtimin e kërkesave për vlerësimin e projekteve të OJQ-vë dhe individëve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kryesues i Komisionit të përbashkët me APK-në për dalje në vënd ngjarje për regjistrimin dhe identifikimin e ndërtimeve në pronat e uzurpuara në bjeshkët e Istogut.

Mjedisi

Gjatë këtij viti janë parashtruar 14 kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale. Janë lëshuar 12 Vendime për LMK të shoqëruar me 12 procesverbale të hartuara në teren. Një kërkesë për LMK nga viti paraprak është kthyer përgjigjeje me konkluzion dhe një Pëlqim mjedisor. Zhvillimi me sukses i Aksionit e Duam Istogun e Pastër, takimi më nxënës për ngritjen e Kapaciteteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit si dhe manifestimi për pastrim të ambientit me rastin e ditës së Tokës 22 Prillit. Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **19.877,80 €**, nga taksa për mbrojtje të ambientit. Në kuadër të detyrës nga Drejtoria për Inspektion, Inspektori i mjedisit janë parashtruar 20 kërkesa- ankese të ndryshme që kemi Hartuar 24 proces verbale prej tyre 4 me udhëzim nga Bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit. Po ashtu kemi qenë pjesë e ekipit në teren së bashku me inspektorë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Po ashtu kam qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, angazhime dhe Punëtori të Ekipeve Komunale AZHR –Perëndim. Bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ka qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor. Realizimin e disa punësive me Organizatën për zhvillim të komuniteteve Bashkëpunimi me UNDP –Dialogu ndërkufitar për mes trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Zbatimi dhe monitorimi i raportimeve Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve. Kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, në bashkëpunim me Inspektorët Komunal dhe të Drejtorive Komunale si Drejtorinë për Bujqësi, Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe atë për Zhvillim Ekonomik, të gjitha këto në bazë të detyrës zyrtare.

Tabela 2. Të hyrat e përgjithshme nga DPUM për vitin 2022.

	Shërbimet brenda Sektorëve të DPUM	Shuma në €
1	Lejet ndërtimore	165.248,81 €
2	Shëndrrimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore	25.855,80 €

3	Lejet për legalizim	11.972.88 €
4	Lejet për mjedis	19.877,80 €
5	Pelqime dhe vërtetime të ndryshme	2.178.12 €
	TOTALI	225.088.41 €

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
RAPORT I PUNËS JANAR-DHJETOR 2022

Viti kalendarik 2022 në DKA-Istog shënon arritjen e shumë rezultateve në fushën e arsimit, qoftë të natyrës, menaxhuese, kadrovike, infrastrukture, që ndikojnë në ngritjen e cilësisë në arsim.

Nga këto veçojmë angazhimin e stafit të DKA-së në menaxhimin e situatës së gjithmbarshme për të siguruar kushte më të mira në mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, plotësimin e vendeve të lira të punës, apo zëvendësime për arsye të ndryshme, organizimin e trajnimeve për mësimdhënës etj.

- Gjatë këtij viti shkollor nxënësit e shkollave në Llukac të Begut dhe në Uçë kanë filluar procesin mësimor në objekte të reja me ç'rast, kushtet për mësim janë shumë më të mira sesa deri me tani.
- Është bërë renovimi i Qerdhës "Pëllumbat e Ardhmërisë" në Rakosh si dhe në paralelet e ndara në Dubravë dhe në Trubohoc.
- Është siguruar transporti falas për nxënësit që udhëtojnë në distanca mbi 4 km thuajse për të gjitha lokacionet.
- Janë ndarë 140 bursa për studentë, 4 bursa për nxënës, si dhe 1 bursë për studentë që studiojnë në universitete ndërkombëtare.
- Janë hapur dhe menaxhuar me kohë 17 konkurse për pranimit të punëtorëve në shkollat tona.
- Janë punësuar 80 mësimdhënës, 10 edukatore, 8 asistente për fëmijë me nevojë të veçanta si dhe 4 punëtor teknik, gjithsej në vitin 2022 në sistemin arsimor në Komunën e Istogut janë pranuar 102 punëtor në vende të lira apo zëvendësime.
- Qerdhja "Lulet e Jetës" në Vrellë është furnizuar me inventar të Ri.
- Janë siguruar uniformat për nxënës, gjegjësisht uniforma është bërë obligative edhe për personelin arsimor konform rregullorës komunale dhe atyre të brendshme shkollore.
- Ka filluar punimi i palestrës sportive në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.
- Është bërë intervenim në të gjitha poligonet sportive të shkollave të komunës sonë për të meremetuar dhe eliminuar defektet ekzistuese, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme dhe të sigurt për nxënësit gjatë shfrytëzimit të tyre.
- Është bërë vendosja e kamerave në të gjitha objektet edukativo-arsimore të komunës sonë
- Projekte kapitale të realizuara gjatë këtij viti kalendarik kapin shumën 125208 €.
- Gjithashtu DKA ka mbuluar shpenzimet e transportit për nxënës në relacione të ndryshme në fshatrat e Istogut në vlerë 65300 €

- E gjithë kjo punë reflektohet apo dokumentohet me numrin e vendime dhe shkresa që kalon shifrën mbi 1000 sosh.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
JANAR-DHJETOR 2022

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2022 ka realizuar disa projekte në infrastrukturë e poashtu janë bërë një varg aktivitete kulturore, rinore e sportive. Këto aktivitete janë organizuar në nivele të shkollave, nivel lokal dhe atë komunal e shtetëror në të gjitha degët.

Projektet e realizuara në infrastrukturë:

Ndërtimi i Qendres Rinore në Uçë

Ndërtimi i Zhveshtoreve në Stadiumin e Futbollit "Demush Mavraj"- faza tretë

Renovimi i Nxemjes Qendrore Në Palestrën e Qytetit dhe furnizimi me lëndë djegëse për funksionalizimin e saj

Mirëmbajtja e Poligoneve Sportive në Shkolla dhe tek Fusha Sportive rrugës për te Burimi.

05/01/2022 - 31/12/2022, Drejtoria: DKRS

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfu
DKRS	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	0	71	27	0	2	0	21	
		0	0	71	27	0	2	0	21	

Sektori i Rinisë:

Licesimi dhe financimi i Qendrës Rinore

Pranimi i Istogut në Programin e Europe Goes Local- në mesin e tre Komunave të Kosovës.

Financimi i Aktiviteteve Rinore

Sektori i Kulturës:

Strategjia për Trashëgimi Kulturor dhe natyror- e cila do të dalë në Kuvend në Muajin Janar 2023

Financimi i Aktiviteteve Kulturor

Shtimi i Numrit të Ekzemplarëve në Bibliotekën e Qytetit të dhuruara nga MKRS

Sektori i Sportit:

Rregullore për Kategorizimin e Sporteve

Financimi i Klubeve Sportive

Vizitë Klubeve Sportive

Në Sektorin e Kulturës janë realizuar këto aktivitete:

Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës është realizuar Promovimi i librit “*Hije që mbesin*” të autores Ardita Lajçi- Gjoci, në sallën e Kuvendit Komunal

Plani Strategjikë për Trashëgimi Kulturor 2023-2027

Koncerti i parë i Muzikës Klasike – nga Jozsef Terek

Për nder të ditës së Çlirimit koncert Festiv në Shtëpinë e Kulturës “*Adem Jashari*” – Istog

Promovimi i katalogut “*Trashëgimia Kulturor e Podgurit*” nga Enver Boletini

Për nder të 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit Kombëtar:

Promovimi i filmit ALISA – në Shtëpi të Kulturës

Vizitë tek Memoriali “*Adem Jashari*” Prekaz

Koncert Festiv – në Shtëpi të Kulturës

Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit janë realizuar këto projekt – aktivitete:

1. Në bashkëpunim me Klubin e Shahut "Istogu është organizuar Turniri Tradicional në Shah kushtuar "Tre Dëshmorëve të Shkollës Shqipe".

2. Për nder të Ditës së Pavarësisë janë organizuar Aktivitete Kulturore.

3. Në bashkëpunim me OJQ "Sporti Shkollor" janë organizuar gara në Futboll të vogël (Futsall), Hendboll, Shah.

4. Në bashkëpunim me Federatën e Sportit Shkollor janë mbajtur edhe gara në Futsall.

5. Mbajtja e takimeve virtuale dhe fizike me organizata rinore në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare- USAID, OSCE, Up to youth.

6. Është organizuar Turnir në Karate në Palestrën e Qytetit" në Istog

7. Dita ndërkombëtare të Sportit për zhvillim dhe paqe në bashkëpunim me KOK

Komuna e Istogut- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përveç këtyre aktiviteteve ka përkrahur Klubet Sportive që janë të licencuara në Federatë përkatëse me mjete financiare

Përkrahje të OJQ-ve Rinore, Kulturore dhe Sportive përmes projekteve.

Me angazhimin e përbashkët me udhëheqësit e klubeve janë zhvilluar shumë aktivitete dhe janë arritur rezultate të Klubeve si: Klubi i Hendbollit" Istogu" është shpallur Kampion i Kosovës si dhe Fitues i Kupës së Kosovës në Hendboll.

Sporti Shkollor ka pasur rezultate të mira në nivel vendi:

SH.F.M.U "Hysni Zajm, Vrellë- Vendin e parë në nivel vendi në Garat në Lojën e Shahut , në garat Republikane

SH.F.M.U " Bajram Curri" në Futsall- vendin e parë në nivel vendi

Qendra Rinore- Istog

1. Takimi me nxënësitë e Gjimnazit "Haxhi Zeka"
2. Takimi me nxënësitë e shkollës së mesme profesionale "Mithat Frasheri"
3. Takimi me të rinjtë, takim njoftues
4. Takimi i dytë me radhë me të rinjt, takim për ndarje në grupe punuese
5. Vizita në Mokën
6. Trajnimi për fotografi dhe editim
7. Trajnimi për marketing
8. Video promovuese për turizmin e Istogut

9. Të rinjtë në ndërmarrësi

10. Shënimi i 12 Gushtit- Dita e Rinisë

- 10 aktivitete të mbajtura
- Afër 1000 të rinjë pjesëmarrës
- 30 të rinjë staf i Qendres Rinore të Istogut
- 5 ide biznesi nga të rinjtë
- Mbi 5500 shikime në rrjete sociale në videon për promovimin e turizmit
- Mbi 150 të rinjë të anëtarësuar

RAPORT I PUNËS SË SHTËPISË SË KULTURËS “ADEM JASHARI” NË ISTOG PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2022, ME SEKTORET E SAJA

Shtëpia e Kulturës “Adem Jashari”, në Istog, gjatë vitit 2022 ka arritë të zhvilloj shumë aktivitete, ndër më të ndryshmet kulturore-artistike, bazuar në kushtet e ka, gjithnjë në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe OJQ-të dhe grupet rinore.

AKTIVITETET SIPAS SEKTORËVE

1.BIBLIOTEKA KOMUNALE “BREZI I RI” MË DEGËT E SAJA

Biblioteka komunale “Brezi i Ri”, funksionon në kuadër të Shtëpisë së Kulturës “Adem Jashari dhe ka dy degë të saja: në Gurrakoc dhe në Istog. Biblioteka në vazhdimësi kryen misionin e vet: në zhvillimin dhe kultivimin e kulturës dhe arsimimit të të gjitha moshave si dhe puna më lexues. Pos punës së rregulltë, gjatë periudhës raportuese, biblioteka respektivisht punëtorët e saj, kanë pasur edhe këto aktivitete:

Viti 2022 ishte vit i suksesshëm si në veprimtarinë e bibliotekës, realizimin e shërbimeve, ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, e posaqërisht në pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj.

Punët profesionale që bëhen në bibliotekë:

- Përpunimi i librit
- Klasifikimi,
- Puna me lexues.

Aktivitetet kulturore :

Biblioteka zhvillon aktivitete simbolike kulturore, siç janë zgjedhja e lexuesve më të mirë dhe shpërblimi i tyre , takime me shkrimtarë etj.

Pasurimi i fondit librar:

Është gjithmonë synimi ynë, këtë vit pranuar një numër të konsiderueshëm librash nga MKRS dhe nga autorë tjerë.

Kemi bashkëpunim të ngushtë me Bibliotekën Universitare në Prishtinë, me bibliotekën “Azem Shkreli” në Pejë etj.

Biblioteka

Amë në Istog dhe Dega në Gurrakoc:

- tituj në gjuhën shqipe.....	7.044.....	1.789
- ekzemplar në gjuhën shqipe.....	18.174.....	6.301
- tituj në gjuhën serbe.....	50.....	0
- ekzemplar në gjuhën serbe.....	50.....	0
- fondi librar i nxjerrë jashtë përdorimit.....	0.....	0
- numri i lexuesëve.....	146.....	78
- libra të lexuar	1415.....	232
- Libra të dhuruar	400.....	330

2.

2. SEKTORI MUZE-ARKEOLOGJI

Aktivitetet:

- Janar-Pjesëmarrja në simpoziumin për lahutën në Gllogjan , me kumtesen: "Lahuta instrument autokton shqiptar".
- Shkurt - Emision promovues me RTV Dukagjinin, Ura e gurit në Zallq.
- Shkurt - me rastin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës , ekspozitë festive në Muzeun Komunal.
- Mars - Vrellë , inspektim i shembjes së murit pranë mullirit të Qelë Bicit.
- Prill - Vizitë studimore të kullave të lagjes Mazrekaj në Drenoc.
- Prill , - Pejë, muzeu etnologji- vizitë studimore.
- Prill - Takim pune me drejtoreshën e Divizionit të trashëgimisë- marrja nën mbrojtje e ish burgut të Gurrakocit.
- Maj - Punëtori për hartimin e strategjisë së trashëgimisë kulturore për Komunën e Istogut, në bashkëpunim me CHVB Prishtinë.
- Maj - Ujëvara e Drinit takim për promovimin dhe integrimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në Dukagjinin përendimor -Rajoni i Pejës.
- Maj - Takim për strategjinë e trashëgimisë kulturore.
- Qershor - pasurim i koleksionit të muzeut me ekspozate të reja -gjilperë metalike antike.
- Qershor - me rastin e ditës së Çlirimit të Istogut, ekspozitë festive në Muzeun Komunal.
- Korrik - eksplorimi i shpellës së Hoxhës në Vrellë, emision propagandues me ATV.
- Gusht - vizita të bashkëatdhetarëve nga diaspora në muzeun komunal.
- Shtator - promovimi i librit – katalogut "Trashëgimia Kulturore e Podgurit"
- Tetor - SHFMU " Ismail Qemali" Saradran në vizitë të muzeut komunal
- Nëntor - nxënës të Gjimnazit " Haxhi Zeka" Istog në vizitë në muzeun komunal

- Nëntor - Yllkat dhe fatosat e Kopshtit të Fëmijëve " Gëzimi Ynë" Istog në vizitë në muzeun komunal.
- Dhjetor - pasurim i koleksionit të muzeut me një VEK artisanal (dhurues nga Isuf Imeri – Kashicë).
- Dhjetor - organizata "Agimi"- Isniq, me nxënës të komuniteteve të përziera në vizitë në muzeun komunal.

3. AKTIVITETE TË TJERA

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar edhe këto aktivitete:

- Shkurt -me rastin e dites se Pavaresise së Republikës së Kosovës , koncert festiv.
- më 21 Maj,u shenua Dita Ndërkombëtare e Kulturës,
- Maj- pjesëmarrja në festivalin gjithëkombëtar në Elbasan " Kënga popullore qytetare"
- Qershor - pjesëmarrja në festivalin gjithëkombëtar " I këndojmë lirisë" kushtuar dëshmorit Mujë Krasniqi-Kapuqi (grupi folklorik " Selman Kadrija i pallatit të Klulturës Adem Jashari").
- Qershor -u shenua 20 qershori-Dita e Çlirimit të Istogut, koncert festiv.
- Gusht- u zhvilluan shumë aktivitete në kuadër të Muajit të Rinisë-22",
- Gusht- pjesëmarrja festivalin gjithëkombëtar në Gjakovë " Sofra e Podgurit"
- Tetor – aktivizimi i shkollës së baletit " DanceëithTringa" për gjenerata të ndryshme në Qendrën Kulturore.
- Nëntor-Shfaqja e filmit vendor " Alisa" në sallën e madhe të kinemasë.
- Nëntor-me rastin e ditës së Flamurit - 28 Nëntorit , koncert festiv.
- Nëntor- Vizitë te kulla e Haxhi Buleshkaj –Istog i Poshtëm.
- Nëntor- Aktivitet per ndërmarrësi nga UP To Youth Usaid.
- Nëntor- pjesëmarrja në festivalin Rapsodia shqiptare në Skenderaj(grupi folklorik " Selman Kadrja") i pallatit të Kulturës Adem Jashari.
- Dhjetor- ekspozita tematike historike,paraqitja e autoktonisë shqiptare Sanxhaku Histori e dhimbjes kombëtare me fotografi dhe dokumenteve arkivore nga patriot dhe kotribues të të gjitha trevave shqiptare me autorë Ismet Azizi e Ali Daci, nga Shoqata "Kosova për Sanxhakun", epspozita ka qenë e kapur për një javë.
- Dhjetor- Koncerti përmbyllës " Gurra e Folklorit Shqiptar" – koncert i Ansamblit te këngeve dhe valleve Selman Kadrija.
- Dhjetor pjesëmarrja në Shqipëri – Shkodër në manifestimin Sofra e Dukagjinit.
- takim me skulptorin akademik Mal Myrtaj për organizimin e e një ekspozite të Artit figurative dhe skulpturave.
- Ambasadorët e paqës , në vizitë në muzeun komunal.
- Aktivitete tjera të ndryshme në sallën e inovacionit , sallën e madhe të kinemasë dhe në hollin e Shtëpisë së Kulturës.

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE HIDROEKONOMI *JANAR-DHJETOR 2022*

Sektori i Bujqësisë

Aktivitetet në periudhën Janar- Dhjetor/2022

Komuna e Istogut përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është e orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë me efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Bujqësia dhe pylltaria janë sektorët kryesorë të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Duke u bazuar në plan programin e punës në kuadër të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

1. Aktivitetet në periudhën, janar- dhjetor 2022

Ne kuadër të DBPZHR-së nga muaji janar janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesorët do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ne muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak ,ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtarja kompetente e arkivës komunale
- Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 4 zyrtar të rinj me kontrata për shërbime të veçanta ,përmes ligjit të prokurorit, të cilët janë trajnuar dhe të përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte
- Janë iniciuar procedurat e prokurimit për projektet kapitale dhe zotimi i mjeteve
- Pranimi dhe përgjigjeje në kërkesa të palëve
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si; vërtetime për fermer, vlerësimi i dëmeve të ndryshme , etj
- Funksionalizimi i zyrës për shërbime këshillimore për fermer dhe ofrimi i këshillave dhe trajnimeve të ndryshme për fermer
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për organizimin e aktivitetit tradicional “Te qethat 2022” , aktivitet i cili ka dështuar në mungesë të aplikimit të OJQ-ve për organizim
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për organizimin e ditës së mollës
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për subvencione për fermer në material fidanor për ngritjen e pemishteve dru frutore dhe mbështetje të kostos së certifikimit të fermave organike
- Organizimi i aktivitetit dita e mollës 2022

- Mbështetja e 23 fermerëve me material fidanor dhe pajisje për ngritjen e pemishteve dru frutore ku janë ngritur 13.13 ha
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për kompensim të kostos së certifikimit organik për subjektet që prodhojnë bimë aromatike mjekuese.
- Realizimi i thirrjes për mbështetje të fermerëve që kultivojnë bimë aromatike mjekësore , në pagesën e faturës së certifikimit organik në vlerën 70 % të kostos
- Vlerësimi i dëmeve nga breshëri dhe dëmet e tjera nga fatkeqësitë natyrore

2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre

2.1 Kërkesat drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Hidroekonomisë

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 376 kërkesa të ndryshme të palëve, në drejtorinë e bujqësisë.

Pranuar	Ne proces	Miratuara	Anuluar	Refuzuara
376	1	231	11	133
Spektori i bujqësisë	1			
Spektori i pylltarisë	0			

- Gjatë fazës së aplikimit të fermerëve për pagesa direkte janë pranuar dhe procedura 1212 kërkesa, të specifikuar si më poshtë:

Nr.	Spektori		Viti 2022	Sipërfaqja/ha	Nr. I aplikacioneve
1	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2.338,54	404
		Grurë kg		3,156.760	94
		Grurë për farë		59.39	1
		Misër		1.749,6	456
		Thekër		14.25	6
		Elb		46.16	28
		Tërshërë		54.25	29
		Lule dielli		2.05	1
2	Perime kulturë	Perime ne fushë		115.58	86
		Perime ne sera		1.17	4

		Fasule monokulturë		5.63	2
		Kunguj misri		10.13	8
		Vreshta		10.68	2
3	Pemëtari	Pemë		324.26	180
		Pemë të imta		4.81	7
		Material fidanor		65.200	1
4	Blegtori	Lopë qumështore		4.299 krerë	449
		Qumësht litra		/	/
		Bletë		8.028 koshere	127
		Dele		7.701 krerë	76
		Dhi		1.341 krerë	16
		Viça për majmëri		/	/
		Dosa		11	3
5	Shpeztari	Pula		30.500	3
		Peshkë		/	/
6	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		44.62	18
7	Bujqësi organike	Organike		109.38	5

Totali i lëndëve të trajtuara ; 1212 copë +376 copë sipas kërkesave të palëve = 1588 kërkesa ne vitin 2023

3. Projektet kapitale

Në këtë vit janë implementuar projekte që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe hapja e një rruge malor dhe mirëmbajtje të rrugëve malore për tu mundësuar qasje më të lehtë blegtorëve në kullosa.

- Betonimi i kanalit të Trubuhocit
- Rregullimi i kanalit të ujitjes dhe rrugës fushore në fshatin Muzhevina
- Betonimi i kanalit të Lubeniqeve
- Hapja e rrugës malore Shushicë-Kosharishtë

- Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot-1 Raudusha dhe Lot 2 Lugu i Butë
- Ndërtimi i " Kroit ne Lugu i Butë "

4. Sektori i pylltarisë

1. Aktivitete për periudhën janar- dhjetor / 2022

- Është vazhduar me aktivitetet të rregullta sipas planifikimeve vjetore, angazhim në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, florës dhe faunës,
- Me vendim të Kryetarit të komunës në muajin korrik janë bërë regjistrimet e përgjithshme të dëmit pyjor
- Rekrutim i stafit roje në laurë
- Është bërë shijimi i masës drunore së bashku me zyrën rajonale të APK-së , për shitje të rregullt dhe për furnizim me qytetarë
- Është bërë lëshimi i lejeve për prerje në pyje private, damkimi dhe dhëna e flet përcjelljeve
- Rekrutimi i stafit roje pylli në laura dhe aktivitete të tjera nga fusha e përgjegjësi të sektorit

Përmbledhje tabelore e aktiviteteve për përdhën raportuese

Shitje e masës drunore në bazë të kontratave			Shitje e lirë për qytetar	Fletëparaqitjet		Konfiskimet		Shitjet totale €
Dru zjarri m³	Ahu teknik m³	Breu m³		Penale	Kundërvajtje	Dru teknik m³	Dru zjarri m³	
3246.97	38.77	00	502.90	15	72	61.57	135.49	52349.11

5. Sfidat

Drejtorja e bujqësisë këtë vit raportues është përballur me sfida të shumta në përmbushjen e detyrave dhe funksionimit si më poshtë

- Mungesë të kompanisë projektuese për përgatitjen e projekteve ekzekutuese
- Mungesë të trajnimeve të stafit për menaxhimin e kontratave të projekteve, vlerësimit të tenderëve.

- Sipërfaqet e tokave bujqësore komunale të cilat nuk janë dhënë ne shfrytëzim përmes ankandit
- Mos themelimi i vend gjuetisë sipas obligimeve ligjore detyrë e lënë pas që shumë vite edhe për kundër kërkesave të vazhdueshme dhe vendimeve të inspektoratit qendror
- Mos bartja në menaxhim të zonës së parkut nacional "Bjeshkët e Nemuna " në kompetencë të drejtorisë së parkut
- Numri i madhe i kërkesave të fermerëve për ndihmë financiare për dëmtim të kafshëve shtëpiake nga kafshët e egra dhe ngordhjet natyrore, objekte bujqësore etj
- Mungesa e planit për menaxhimin e tokave bujqësore
- Mungesa e Planit shumëvjeçar për bujqësi dhe zhvillim rural

6. Rekomandime

- Vazhdimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore për periudhë afat shkurtër (1-15 vite) .
- Organizimi i trajnimeve për stafin në menaxhim të kontratave, vlerësim të tenderëve dhe vlerësim të punimeve të kryera
- Bartja në menaxhim të zonës së parkut nacional " Bjeshkët e Nemuna ", që shtrihet në territorin e komunës së Istogut, në Agjencinë për mbrojtje të Mjedisit, e cila vazhdon të menaxhohet gabimisht nga Komuna e Istogut
- Themelimi i vend gjuetisë, një punë e filluar në vitin 2014 e cila ka mbetur e pa përfunduar edhe sot e kësaj dite.
- Hartimi i planeve strategjike për bujqësi dhe zhvillim rural dhe planit për mbrojtjen e tokës bujqësore.

7. Përfundim

Me gjithë sfidat e lartë cekura, në kuadër të stafit të drejtorisë ka pasur angazhime në përmbushje të detyrave dhe implementim të projekteve. Po ashtu gjatë kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur kontakte të rregullta me institucionet e nivelit qendror, shoqata të ndryshme dhe komunikime të tjera, me qëllim të ndikimit që përmes këtyre aktiviteteve të përmissohen dhe ndihmohen fermerët në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.

Implementimi i rekomandimeve të lartcekura do t'i mundësojë sektorit të bujqësisë një funksionalizim dhe përmbushje të detyrave dhe të kompetencave sipas ligjeve në fuqi. Mungesa e stafit të rregullt po pamundëson edhe themelimin e disa komisioneve profesionale shumëvjeçare që na obligojnë aktet ligjore në fuqi.

Me respekt

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

JANAR-DHJETOR 2022

Shëndetësia paraqet një segment të rëndësishëm për Komunën dhe si e tillë gjatë kësaj periudhe e tërë puna dhe angazhimi i Drejtorisë për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë një vizitë në QKMF dhe të gjitha qendrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe nevojat e tyre. Fillimisht kemi ndërmarrë disa hapa të cilët shkojnë në funksion të përmirësimit të shërbimeve në QKMF për qytetarët e komunës tonë. Fillimisht jemi fokusuar në shërbimin e emergjencës, shërbim ky të cilin më së shumti e frekuentojnë qytetarët. Hapin e parë të cilin e kemi ndërmarrë në këtë shërbim është angazhimi i dy mjekëve dhe dy infermierëve në një ndërrim për 24 orë. Pastaj vëmendja i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rentëgenit dhe shërbimit të Labotatorit). Për funksionimin sa më të mirë dhe pa ndërpre të këtij shërbimi, kemi kontraktuar kompani të cilat kanë bërë furnizimin me reagenca dhe filma për rentgen. Kemi bërë e zgjerimin e listës së analizave të cilat mund të kryhen në këtë shërbim. Ndryshime janë bërë edhe në shërbimin e Mjekësisë Familjare. Ky shërbim gjatë vitit 2022 ka punuar nga ora 7⁰⁰- 20⁰⁰.

Furnizimi me barna nga lista esenciale, e cila realizohet nga Ministria e Shëndetësisë, gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë e kënaqshme, prandaj nga buxheti i komunës kemi qenë të detyruar të bejmë furnizimin me medikamente të cilat janë të domosdoshme për funksionimin normalë të shërbimeve. Për këtë qëllim nga buxheti i komunës deri me tani janë shpenzuar rreth 72,500.00€.

Sa i përket projekteve të cilat kanë qenë të parapara për vitin 2022 kemi realizuar këto projekte:

Ndërtimi i Ambulancës së Mjekësisë Familjare në Fshatin Veriq e cila buxhetit të Komunës i ka kushtuar **49,645.00€**. Është bërë përrurimi i kësaj ambulance dhe e njëjta ka filluar punën në të cilën punon mjeku dy herë në javë dhe infermierja gjatë tërë javës nga ora 7⁰⁰- 14⁰⁰. ;

Ndërrimi i kulmit në QMF Banjë dhe Renovimi i kulmit në QMF Gurrakoc, është përfunduar me sukses dhe i njëjti ka kushtuar **10,943.20 €**;

Është bërë ndërtimi i rrethojës në Ambulancën e fshatit Uçë e cila ka kushtuar rreth **12,600.00€**

QKMF është paisur me Momagraf i cili buxhetit të komunës i ka kushtuar **48,885.50€**.

Shqyrtimi i kërkesave- Gjatë kësaj periudhe, kësaj drejtorie i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesa për ndihmë finaciare për shërim dhe blerje të medikamenteve, për këtë qëllim janë ndarë 20,000.00€ dhe deri me tani kanë përfituar mbi 145 individ. Kemi pasë edhe një numër të madhë të kërkesave për kompenzimin e shpenzimeve të karburantëve për personat të cilët janë në Hemo-dializë, të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe si mjet transporti përdorin automjetin privat pastaj për personat të cilët trajtohen me kemio-terapi dhe rrezatim në institutin Onkologjik pranë SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime deri me tani janë dhënë 15347 lit. Karburantë në shumë prej 22,240.00€

Edhe në këtë vit kemi vazhduar me projektin me bashkëfinancim të Komunës së Istogut dhe Caritas Kosova me titull “ **Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator -Home Care 2022**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Caritas Kosova dhe zgjat nga 01.01.2022 deri me 31.12.2022. Vlera e këtij projekti është 130,000.00€. Caritas Kosova, do të participoj në këtë projekt me pajisje, Infrastrukturë menaxhuese, pajisje shëndetësore në vlerë prej 15,000.00 €, ndërsa Komuna e Istogut për këtë qëllim ka ndarë shumën prej 115,000.00€. Përmes këtij projekti kemi realizuar punësimin e 25 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë. Përmes këtij projekti gjatë këtij viti janë realizuar qindra vizita shtëpiake duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamentëve esenciale nga barnatoria qendrore e Qkmf- së Istog, sigurimi i gazave, instrumentëve sterile, sigurimi i katetrave , qesëve për stomë etj.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE -ISTOG

Vizita mjekësore, Në QKMF, QMF dhe AMF janë kryer 383000 vizita mjekësore, shërbimi i stomatologjisë 3267 shërbime, laborator 9529 shërbime laboratorike, radiologji 10477 shërbime radiologjike.

Numri i shërbimeve Infermierore, duke përfshirë dhënia e terapisë paranterale, lidhje pastrim plage etj gjithsej janë kryer rreth 368475 shërbime.

Numri i vizitave shtëpiake, Nga ekipi mjekësorë mjek, infermier si dhënia e terapisë intravenoze, vendosja e kateterit si dhe shërbime tjera janë kryer 676 shërbime .

Vizita mjekësore nga Shëndeti mendorë, ekipi i Shëndetit Mendor -Pejë mjek -infirmier kanë kryer vizita mjekësore për 437 klient si dhe trajtimi me terapi muskulare me moditen amp dhe Haldol ampula 310 amp.

Pacintë të varur me insulina gjithsej 292, për këtë kategori janë dhënë :

Insulina : Novo Mix 9759, Novo Rapid 2230 dhe Leverimir 1128 copë

Maternitet dhe gjinekologji:

Gjatë kësaj periudhe në Maternitetin e QKMF -Istog janë kryer 5 lindje,

Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë janë kryer 572 vizita.

Vizita gjinekologjike janë kryer 278 vizita.

Vaksinimi:

Vaksina dhe shërbime në shërbimin e vaksinimit

Vaksina total të aplikuar	12108
Vaksina të rregullta	8066
Vaksina Sezonale	1799
Vaksina antiCovid-19	2243

Hemodializa:

Transport i pacientëve për Hemodializë në Spialin Rajonal -Pejë është bërë 3 herë në javë .

Numri i pacientëve që janë transportuar për nevoja të hemodializës gjatë kësaj periudhe ka qenë 11 pacientë.

**DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM
JANAR-DHJETOR 2022**

Bazuar në Planin e Punës së Drejtoratit për vitin 2022 dhe situatat emergjente që ndodhin si pasojë e fatkeqësive natyrore, Drejtorati ka ndërmarrë veprime si në vijim.

Drejtorati ka bashkëpunuar me MPB-në, gjegjësisht AME-në dhe Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, si dhe ka konsultuar një ekspert nga Italia në fushën e rrëshqitjeve të dheut. Drejtorati ka vizituar vendin e rrëshqitjes së dheut në Vrellë vitin 2021 dhe ka konstatuar se duhet të bëhet një vlersim gjeomekanik i dheut në afërsi të Mullirit të Bicajve para se të ndërmerren masa eventuale për sanimin e gjendjes nga rrëshqitja e dheut e vitit 2021.

Drejtoria ka ndërmarrë masa për sanimin e rrugëve nga zalli dhe gurë nga reshurat e shiut në bashkëpunim me ndërmarrjen Ambienti. Poashtu Drejtoria ka ndërmarrë masa për trajtimin e qenëve endacak bazuar në kontratën me operatorin ekonomik. Megjithatë, është e nevojshme një bashkëpunim i gjerë me komunat fqinje për trajtimin e këtij problemi, i cili nuk është i vetëm në Istog, por në të gjithë Kosovën.

Problemi i mos aplikimit të operatorëve ekonomik për mirëmbajtjen e autoteknikës së NJPZSH-së është një problem i veçantë që ndikon në nivelin e gatishmërisë së Zjarrëfikësve për intervenime emergjente.

Zyrtarë të Drejtorisë kanë bërë vizita në teren për identifikimin e objekteve (drunjë apo ndërtesa) që paraqesin rrezik për sigurinë e qytetarëve.

Regenerate response

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

- ❖ Plani i Gatishmërisë Emergjente i cili është bazë për hartimin e Planit Operativ Emergjent është plotësuar me shënime të reja siç janë shënimet nga institucionet e Arsimit dhe Shëndetësis.
- ❖ Plani Operativ Emergjent është hartuar mbi 90% nga Sektori i Emergjencave por duhet plotësuar edhe nga disa Drejtori për tu dërguar në Asamble Komunale për miratim
- ❖ Plani në rast tërmeti është bërë grumbullimi i shënimeve të familjeve që banojnë në ndërtesa shumë katshe ku pason hartimi i planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku.
Po ashtu lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve ligjore normative dhe mungesa e hapësirave për strehim, gjegjësisht strehimoreve. Për këtë arsye jemi në fazën e identifikimeve të Bodrumeve në objekte kolektive duke identifikuar edhe pronarët me qëllim vlerësimi për shfrytëzim si strehimore në raste emergjente
- ❖ Jemi në procesin e evidentimit të ndryshimeve në ndërmarrje sa u përket mjeteve për reagim emergjent në komunën tonë me shënime të duhura nëpër firmat e nevojshme me qëllim të angazhimit të teknikes sipas nevojës. Lista egzistuese është në plotsim e sipër. Do të ishte mirë që Drejtoria e Administratës së bashku me Drejtorin e Financave të nënshkruajn marrveshje e mirkuptimit në pritje, me klauzul se kompenzimi për angazhim do të bëhet proporcionalisht me çmimin e tregut në ditën e angazhimit në intervenim.
- ❖ Sektori është përgjigjur kërkesave të qytetarëve me shkrim siç janë: lëshimi i certifikatave mbi shërbimin ushtarak, vërtetimi për plotësimin e kushteve për mbrojtje nga zjarri,

vërtetime në raste të djegëjes së shtëpisë apo pronë personale, ndihma për dëmet e krijuara nga era-vershime etj.

- ❖ Në kuadër të zyrës për alarmim dhe informim është përpunuar plani për mbulimin e territorit të komunë sonë me radio rrjetë. Në mungesë të mjeteve materiale nuk ka mundur të realizohet ky projekt.
- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB-së) në realizimin e projekteve në bashkëpunim me UNDP-në, me qendrën për informim dhe siguri si dhe në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Sherbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të denuarve me punë në dobi të përgjithëshme.

Problem të madh paraqet komunikimi në raste të fatkeqsive (situata emergjente), sistemi i radiolidhjeve nuk funksionon fare. Ne si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave bazuar në kërkesat e qytetarëve, si dhe kemi kontribuar në hartimin e projekteve të ndryshme nga lista e projekteve të parapara për këtë vit.

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2019

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera Jan-Qersht 2022

9	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar zj. qyt. tot	Të vdekur zj. qyt. tot					
at	16	12	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	21	17	2	0	2	0	0	0	5	5	0	0	0	0
	54	49	2	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	19	17	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
or	14	2	4	6	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0
k	9	5	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
t														
or														
or														
sejë	133	102	11	16	4	0	0	0	7	7	0	0	0	0

	LLOJI I INTERVENIMIT	Jan	Shk u.	Ma r.	Pril l	Maj	Qer sh	Ko rr.	Gu sh.	Sh ta.	Te t.	Në nt.	Dhj e.	GITHË SEJ.
1	ZJARRË	12	17	49	17	2	5							102
2	INTERVENIME TEKNIKE	2	2	2	0	4	1							11
3	SHËRBIME	2	0	3	2	6	3							16
4	AKSIDENTE	0	2	0	0	2	0							4

	KOMUNIKACIONI													
5	VËRSHIME	0	0	0	0	0	0							0
6	ALARME TË RREJSHME	0	0	0	0	0	0							0
	Gjithësejtë:	16	21	54	19	14	9							133
1.	Ndarja analitike e zjarreve në:	OBJEKTE NDËRTIMORE												
1.1	Banesa – shtëpi	3	0	0	0	0	1							4
1.2	Objekte ndimëse	1	0	0	0	0	0							5
1.3	Plevica - shtalla	2	0	0	0	0	1							3
1.4	Objekte kolektive (banesa)	0	0	0	0	0	0							0
1.5	Oxhaqe	2	2	1	1	0	0							4
1.6	Të tjera	0	0	0	0	0	0							0
	Gjithësejtë:	8	2	1	1	0	2							16
2.	Ndarja analitike e zjarreve në:	OBJEKTE EKONOMIKE												
2.1	Publike	0	0	0	0	0	0							0
2.2	Objekte Biznesi	0	1	1	1	0	0							3
2.3	Objekte Indusiale	0	0	0	0	0	0							0
2.4	Të tjera	0	0	0	1	0	0							1
	Gjithësejtë:	0	1	1	2	0	0							4
3.1	Paisjet elektrike / trafo	0	0	0	0	1	0							1
3.2	Paisjet shpërndarëse	1	2	0	0	0	2							5
3.3	Gjenerator	0	0	0	0	0	0							0
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0							0
	Gjithësejtë:	1	2	0	0	1	2							6
4.	Ndarja analitike e zjarreve në:	SIPËRFAQE TË HAPURA												
4.1	Mal	0	2	25	9	1	0							37
4.	Sipërfaqja e djegur (	0	04.0	123	63.	05,	0							196.00

2	hektar)			.5	5	0							
4.	Bari i thatë	2	3	19	2	0	1						17
3													
4.	Sipërfaqja e djegur (	3.5	21.0	160	6,0	0	6.0						196.50
4	hektar)	0	0	.0	0		0						

Sektori i parandalimit :

Angazhimet në AKSP/ FSP , në këtë vit kanë qenë shumë intensive dhe deri me datën 10.06.2022 kemi qenë të angazhuar maksimalisht.

Nga intervenimet e cekura më lart, për 22 raste janë punuar raportet përkatëse

Të gjitha këto raste janë shoqëruar më dëme materiale dhe fatmirësisht pa viktime në njerëz, një rast është shtëpi më dëme të konsiderueshme, 2 nga rastet janë objekte përcjellëse si shtalla etj.

Është nxjerrur vendimi për përgaditjet e fushates së korrje-shiorjeve për vitin 2022, nga Drejtorija për Bujqësi dhe Pylltari (si bartëse e këtijë aktiviteti) mbetet të organizoj një takim me bujqit, kombajneret, deponuesit dhe perpunuesit e grurit në komunën tonë. Në takim do të informohen të lartëcekurit për të gjitha detajet organizative dhe masat mbrojtëse që duhet respektuar.

Duhet cekur se një numër i zjarreve është shkaktuar edhe nga rrjeti furnizues elektrik i cili në disa fshatra është në gjendje shumë të keqe dhe paraqet rrezik për sigurinë e qytetarëve, duhet cekur rrjetin elektrik Tuçep-Osojan, ana juglindore. Ky rrjet ka vite që nuk është sanuar gjendja.

Janë nxjerrë komunikata sensibilizimi për qytetarë për të shtuar kujdesin në sezonin veror, me këshilla për mënyren e sjelljes së tyre gjatë këtijë sezoni. Komunikatat janë transmetuar përmes mjeteve të informimit lokale si dhe rrjeteve sociale.

Forma tabelare e rasteve të zjarreve për të cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vendshikimi e rastit, 2022

Nr. dhe data	Pronari	Shtepi / biznes	Obj. percjell ëse	Te tjera (ushqim bagëti je dru prod.buj q. vetura), etj.	Shkak i zjarrit.	Dëmet	Shenime
Date :03.01 . 2022 Nr: 001/ '22	Sahit (H a x h i) S a d r i a j nga C e r k o l e z i . Rruga „ F u s h a e D a r d			Strehë, e ushqimit te bagëtisë me dimensio ne 30x5m njëra dhe 15x5m tjetra	Perdorimi I fishekzjarr eve	Te konsiderues hme	moskujdesi me mjete pirroteknike

	h a v e " n r : 1 5 7						
Date :04.01 . 2022 Nr: 002/ '22	Dinë (Zekë) Mahaj nga Dubova e Vogël, rr Driloni,	Shtëpi, me dimensione 10 x5m.			Oxhaku	e tërë shtëpija me orenditë përkatëse	Oxhak I improvizuar me qynga llamarine
Date :07.01 . 2022 Nr: 003 / '22	Rruga „Rinija”. Rasti kishte të bënte me banesat me hyrjet 135 dhe 137			Njehsoret elektrik	Lageshtija, pikonte uji neper instalim		Mosmirëmbajtja
Date :07.01 . 2022 Nr: 004 / '22	Qazim Metaj në Banjë rruga „Mujë Dreshaj”, nr 36			Veturë pune , opel vivaro , 03-563-FF	Zjarrvëniet	E tërë vetura, me vegleri pune	
Date :18.01 . 2022 Nr: 005 / '22	Nexhdet (Rexhep) Balaj nga Zabllaqi rruga		objekt përcjellës, ndodhej aparatura e		Invertoret dhe pranija e brejtesve.	instalimi dhe invertoret, kulmi një pjesë e vogël.	Mosmirëmbajtja

	„Ahmet Balaj”, nr 56		ngrohje s.				
Date :19.01 . 2022 Nr: 006 / '22	Ramë Malesha j nga Veriqi rruga „Verrini ”.	Shtëpi banimi, e ndërtuar nga donacione , probleme me instalim elektrik			instalim I I dobët, disa shtëpi te ndërtuara si donacione kan instalim joprofesional	Një dhomë, kulmi, banjoja, koridori, orenditë dhe instalimet përkatëse.	Shtëpitë e ndërtuar nga donacione kan një instalim të dobët.
Date :20.01 . 2022 Nr: 007 / '22	Radan Dzoliq nga Tuqepi rruga „Bajram Mehmet i ”, nr 186	Shtëpi banimi, e ndërtuar nga donacione , probleme me instalim elektrik			instalimi I dobët elektrik si dhe rrjeti I dobët furnizues.	banjoja, instalim elektrik dhe sanitarie, një murë ndares mes banjos dhe	I tërë instalim është I ekzekutuar në kabllo 1.5mm, rrjeti furnizues në gjendje shumë të keqe.
Date :21.02 . 2022 Nr: 008 / '22	A&B COATI NG, me pronarë Bekim Haxhijaj , „Lidhja e Pejës ”, nr 375	biznes , zyra administratëe firmes			instalim joprofesional, prani e brejtësve dhe shpendëve	hapsirë e tavanit rreth 4m ²	
Date :26.02 . 2022 Nr: 008 / '22	Selim Kajtazaj nga Uça, „Fehmi Demiri ”, nr 101			ushqim bagëti	zjarrvënije		
Date :23.03 . 2022 Nr:	Zenel S e j	shtëpi			oxhaku, o ndihmuar nga era	rreth 10m ² e kulmit	mirmbajtja jo e duhur e instalimeve, oxhakut

010 / '22	d a j, „Lidhja e P r i z r e n i t ” , n r ; 1 1 1 .						
Date :24.03 . 2022 Nr: 011 / '22	Zharko (M a t e o) G j u r i q (Z a r			zjarr I hapur, barishte dhe shkurre	moskujdes njerëzor	0.5ha	moskujdesi

	k o D u r i ć) Osojan Rr; „13 Gushti”						
Date :29.03 . 2022 Nr: 012 / '22	Petko (Velimir) Miletij fshati Oprashk ë			zjarr i hapur	moskujdes njerezor, zjarrëvenij e , pastrim fushash	2 ha	pastrimi nga barojat, neglizhimi i zjarrit
Date :29.03 . 2022 Nr: 013 / '22	C e r k o l e z			zjarr i hapur, malor		10 ha, mal dushku	neglizhim I zjarrëve për shkak pastrimit
Date :31.03 . 2022 Nr: 014 / '22	Bali dhe Zekë Pukaj nga fshati Drejë Rr: „Uniteti ” nr; 112			zjarr hapur, malor	duket te jet zjarrvënije	0.5 ha, mal I rritur dushku	
Date :01.04 . 2022 Nr:	Hysen I m e r			zjarr I hapur, malor	duket të jetë zjarrvënije	2ha mal, bimesi e ulet dhe shkurre	

015 / '22	a j, n g a U ç a						
Date :04/. 04. 2022 Nr: 016 / '22	Samir Gashit, në oborrin e SHMU „Bajram Curri”	biznes, kioskë			dyshohet për zjarrvënije	një çadër për hije	
Date :09.04 . 2022 Nr: 017 / '22	Nexhat (Rexhep) Mulaj Gurrakoc, rruga „7 Marsi” nr; 126			vetaksident, I vë flaken vehtes			personi vdes ps 2 ditesh.
Date :28.04 . 2022 Nr: 018 / '22	Burim Haskaj, Rr; „Deshmoret e Kombit	biznes, fabrikë peleti			instalimi elektrik, prani e brejtesve	pjesë te paisjeve instalimeve elektrik	mosmirmbajtja . Prani e brejtësve
Date :04.06 . 2022 Nr: 019 / '22	Faik (Ibish) Maraj në Vrellë, rruga „Niman Demaj” nr;46	shtëpi			goditje e rrufesë	rreth 10m ² kulm, paisje elktroamvisnise	
Date :04.06 . 2022	Bashkim (Sadik) Shoshi,	shtëpi			lidhje e shkurt elektrike,	njehsori me siguresat	shtëpija e rregulluar por e

Nr: 020 / '22	Studenic ë, rruga „Qazim Hakaj ” nr;108				shkaktuar nga shirat e rrembyesh em		pabanuar
Date :07.06 . 2022 Nr: 021 / '22	Samir G a s h i , SH.M.U “B a j r a m C u r r i ” n ë I s t o g , r r u g a e ” U Ç	biznes, kioskë			lidhje e shkurt elektrike, shkaktuar nga kabloje furnizuese	kablo instalimi, njehsori dhe siguresat mund te jen demtuar	kabloja furnizuese e ekzekutuar jasht normave teknike.

03 .04. 2019	Kosh, Osojan, Belicë, Polanë, pronë publike			Zjarrë I hapur Siperfaqe pyjore	Zjarrvënije	Siperfaqe e konsideru eshme	Zjarrë I cili zgjatë me dit.
Nr: 012 / '19							
	K - e s "						
Date :10.06 . 2022	Rexhep Sejdiaj, Kovragë , rruga „Rrapi” nr: 19		Objekt percjell es, shtallë pa bagëti e perdor ur per lënien e vegleri ve		Instalim I improvixu ar ne object, kablo pa mrojtje, prani e brejtesve	një pjesë e kulmit, instalim,	instalim I pa mbrojtur.
Nr: 022 / '22							

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpetim
Sektori i mbrojtjes dhe shpetimit

Tabela me informacionet e nevojshme për ndërtimin e bazës së të dhënave për situata emergjente.

1. Personeli

Emri i individit 'Ekipi/Grupi (si njësi e pandarë)	Veta në Ekip/ Grup	Nr.i indiv/Ek ipeve/ Grupev e	Mundësitë transportuese		Pajisjet vetanake për njësi	Vërejtje
			Pesha në kg	<u>Njerëz</u>		

Komiteti për vëbrojtje dhe shpëtim	11	1		7	Mjetet themelore për reagim	S'ka pajisje adekuate
DSHPMSH	15	3		5		"
SHKMCE	25	1		9		"
Vjësia komunale e MCE	6	8		48		"
Shëtabi i MCE në BL	32	1		32		"
Ekipet e MC në BL	6+1	30		210		"
Policia e Kosovës – Rajoni i Prishtinës	3+1	6		24	Mjetet e nevojshme për reagim	Sipas nevojës
FSK	1+1	5+5		11+10	"	
DJQ	1	3+3		9+9	"	
BZP	6+1	30x4		120	"	
Kryqi i Kuq	4+1	5x3		15		

Shenjat e radiorrjetit dhe thirrjeve

PERSONELI	RADIORRJETI DHE KANALI	THIRRE SHENJËN
Shërbimi i zjarrfikësve	Semidupleks VHF – kanal i veçantë	Zjarri -93
Komiteti i menaxhimit emergjent të krizës (KMEK)	Semidupleks VHF-16-nënkana	Drini - 1
Shefi i KMEK	"	"
Zyrtari i mediave	038/234-931	
Zyrtari i policisë	112	92
Zyrtari i FSK-së	VHF	Drini - 90
Zyrtari i shërbimit emergjent		Drini - 94

Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq	038/548-988	
Përfaqësuesi i OJQ-ve		
QAKE	VHF dhe UHF 038/245-666 – 245-777	Drini

Vërejtje: -sistemi i radiolidhjeve me frekuencën
-semiduplex VHF dhe UHF
-sistemi i kamerave

DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE **RAPORT PUNE JANAR-DHJETOR 2022**

Qendra për punë sociale

- **Funksionalizimi i objektit të ri të qps** – Qendra për punë sociale është rivendosur në një objekt tjetër duke krijuar kushte më të favorshme për punë
- **Mirëmbajtja e qendrës për punë sociale** – është bërë gelqërosja e zyreve në qendrën për punë sociale dhe hapësirave tjera brenda objektit.
- **Renovimi i banesës së socialit** – është renovuar një pjesë e kulmit të banesës së socialit ku ka shkaktuar dëme tek banorët në atë objekt , gjithashtu koridoret janë lyster dhe banesa e të dëmtuarit.
- **Shpërndarja e pakove ushqimore për familjet në nevojë** – Drejtoria për mirëqenie sociale ka ndihmuar familjet në nevojë me pako ushqimore , ku së bashku me donator kemi shpërndarë gjithsej 400 pako gjatë vitit dhe së fundi kemi marrë iniciativën për ti mbështetur familjet në nevojë me pako ushqimore për festat e fundvitit
- **Perkrahja e familjeve me dru zjarri** - Kemi perkrahur disa familje me dru zjarri në bazë të mundësive buxhetore që kemi pasur
- **Plani 3 vjeçar për banim social 2023-2025** - Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka hartuar planin tre vjeçar për banim Social me qëllim të adresimit të qeshtjeve të banimit

- **Subvencionimi i Familjeve strehuese** - në bashkpunim me zyren e kryetarit janë subvencionuar dy familjet strehuese dhe janë përkrahur në formë të ndryshme
- **Sigurimi i banimit për familjet në gjendje të rëndë ekonomike** – gjatë këtij viti janë realizuar gjithësej 20 pagesa të qirasë për familjet në kushte të vështira ekonomike që nuk kanë mundur të mbulojnë shpenzimet e qirasë

Shtëpia Rezidenciale

Inspektimet javore në shtëpinë e komuniteteve në Gurrakoc .

Servisimi i kamerave – Nga mesi i këtij viti shtëpia e komuniteteve në Gurrakoc për herë të parë është e paisur me kamera brenda objektit

Inventarizimi i shtëpisë së komuniteteve në Gurrakoc- kemi iniciuar procedurë për ndërrim të inventarit me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së rezidentëve .

Shëtitje periodike - kemi realizuar disa shëtitje periodike për rezidentët ku përmes këtyre aktiviteteve synojmë ngritjen e mirëqenies së rezidentëve brenda shtëpisë së komuniteteve në Gurrakoc

Furnizim me veshmbathje – kemi iniciuar procedurë për furnizim me veshmbathje për rezident

Mirëmbajtja e objektit – gjatë kësaj periudhe në shtëpinë e komuniteteve në Gurrakoc është mirëmbajtur (gëllqërosur) objekti brenda dhe jashtë dhe është bërë renovimi i kuzhinës

Paisje me dyshek decubitus – Gjdo rezident i cili është i palëvizshëm i është siguruar dysheku decubitus , dhe falë një donacioni tani çdo rezident ka shtrat lëvizës

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE , JANAR-DHJETOR 2022

Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Dhjetor-2022 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar gjithësej 802 kërkesa nga ato kërkesat janë :

- Të miratuara526
- Të refuzuara.....239

- Hedhur poshtë1
- Pezulluar.....1
- Anuluar 3
- Në Proces.....32

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetarët janë të natyrave të ndryshme dhe atë për:

Licencë Auto-Taxi,

Kërkesa për furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit,

Kërkesa për furnizim me material ndërtimor për raste emergjente,

Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport , sinjalizim, mirëmbajtje te akseve rrugore),

Kërkesa për furnizim me Zhavor për rrugët lokale te pa asfaltuara,

Kërkesë për prerje Asfalti,

Kërkesa për shpenzime të varrimit,

Kërkesa për strehim dhe ndihmë në ndërtimin e shtëpive, etj.

SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe bazuar në kërkesat e qytetareve kemi dalë në teren duke shqyrtuar dhe analizuar të gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dalë në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetarëve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me material ndërtimor, furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit etj.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vjetore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen të tenderëve të paraparë në planin buxhetor, me ç'rast janë realizuar këto projekte:

- Mirëmbajtja e ndriçimit publik ne vlerë prej 30,000.00€,
- Blerja dhe furnizimi me gypa te kanalizimit dhe ujësjellësit ne vlerë prej 22,000.00€.
- Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore ne vlerë prej 55,000.00 €,
- Ndërtimi i deponisë në Tuqepne vlerë prej 18,000.00€,
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale te rendit të IV-të ne vlerë prej 67,000.00€,
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara ne vlerë prej 60,000.00€,
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal ne vlerë prej 20,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog në vlerë prej 28,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Saraderan në vlerë prej 14,000.00€,

- Ndërtimi i ndriçimit publik në Tomoc në vlerë prej 5,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Cerrcë në vlerë prej 12,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Trubuhovc-lagja Osmanaj në vlerë prej 10,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Studenicë dhe rruga “7 Marsi” në vlerë prej 26,500.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Trubuhovc – Qetaj Bajraktari etj. në vlerë prej 25,500.00€,
- Mirëmbajtja e pusetave ne territorin e komunës ne vlerë prej 10,000.00€
- Ndërtimi i kanalizimit në Kashicë-lagja Brahimaj dhe Kelmendi ne vlerë prej 28,000.00€,
- Ndërtimi i kanalizimit dhe infrastrukturës lagja Rexheaj te vaga ne vlerë prej 12,000.00€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Cerrcë-lagja Idrizajne vlerë prej 15,000.00€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë-lagja Kadajne vlerë prej 5,000.00€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Istog të Poshtem-lagja KurtajLlapajne vlerë prej 30,000.00€,
- Ndërtimi i ujësjellësit në Banjë ne vlerë prej 26,500.00€,
- Ndërtimi i kanalit vërshues në Lubozhdë shala e Kodrës ne vlerë prej 25,000.00€
- Ndërtimi i varrezave dhe infrastrukturës në fshatin Vrellë ne vlerë prej 55,000.00€,
- Ndërtimi i urës në Drejt lumi Kujavq, ne vlerë prej 35,000.00€,
- Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike ne territorin e komunës së Istogut, ne vlerë prej 14,000.00€,
- Ndërtimi i infrastrukturës së varrezave në Orroberddë, ne vlerë prej 6,000.00€,
- Ndërtimi i infrastrukturës së varrezave në Kerninë të Epërme dhe të poshtme, ne vlerë prej 8,000.00€,
- Ndërtimi i infrastrukturës së varrezave në Lubozhdë, ne vlerë prej 23,000.00€,
- Mirëmbajtja e deponisë dhe hapësirës përreth, ne vlerë prej 5,000.00€,
- Mirëmbajtja e parkut të qytetit, ne vlerë prej 5,000.00€,
- Mirëmbajtja e sistemit te kamerave të sigurisë në komunën e Istogut, ne vlerë prej 10,000.00€
- Është hartuar Plani Komunal per menaxhimin e mbeturinave në territorinë e komunës së Istogut
- Është hartuar Plani investiv për Ujësjellës dhe kanalizim për territorin e komunës së Istogut
- Është ne hartim e sipër rregullorja për menaxhimin e mbeturinave
- Është ne hartim e sipër PVQEK-SECAP(plani i veprimit te qëndrueshëm në energji dhe klimë)

Po ashtu ne aspektin profesional ne si sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogarit, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë, si dhe në mbikëqyrje të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të ndryshme.

Janë mbledhur te dhënat e objekteve te komunës të cilat konsumojnë energji si energjia elektrike, uji i rrjedhshëm ngrohje dhe klimatizim nga muaji janar deri ne qershor 2022, te dhënat janë futur ne softuerin ENMASOFT.

Ne komunën e Istogut janë të regjistruar 61 ndërtesa te komunës qe konsumojnë energji konsumi i energjisë është ne ngrohje ,ne energji elektrike, ndriçim ,uji i rrjedhshëm dhe karburant te automjeteve qe menaxhohen nga komuna .

Gjatë periudhës janar –qershor janë menaxhuar- është përcjell gjendja e :

59 njehsor elektrik të ndriçimit publik

18 njehsor elektrik të ndërtesave te administratës komunale

40 njehsor elektrik të objekteve arsimore

18 njehsor elektrik të objekteve sociale dhe shëndetësore

10 matës te ujit te ndërtesave administratës komunale

15 matës te ujit te objekteve sociale dhe shëndetësore ,

34 matës te ujit te objekteve arsimore ,

Ne muajit janar ,shkurt ,mars dhe prill është përcjellur dhe gjendja e ngrohjes së institucioneve të komunës se Istogut .

Komuna e Istogut ne këtë periudhë ka bashkë financuar me MFK –SEEK për ndihmë në përkrahje për katër njësi banimi banim individual për efijencë të energjisë , shuma totale e projektit 41,387.57 € ; nga MFK –SEEK 33,676.95 € ; nga Komuna Istog 7,710.42 € .

Komuna e Istogut ka nënshkruar marrëveshje për shërbime të energjisë ndërmjet Fondii Kosovës për Efijencë te Energjisë ne këto Objekte :

- ✓ Zbatimi i masave te Efijences se Energjisë ne Ndriçimin Publik në rrugën Besim Kabashi ne Gurrakoc vlera e projektit 9,163.00 €;
- ✓ Zbatimi i masave te Efijencës së Energjisë ne IP „Pëllumbat e Ardhmërisë “ Rakosh vlera 49,460.00€
- ✓ Zbatimi i masave te Efijencës së Energjisë ne SHFMU „Ismail Qemali “ në Trubuhoc vlera 40.738.70€
- ✓ Zbatimi i masave te Efijencës së Energjisë ne SHFMU „Bajram Curri” Dubravë vlera 49,387.85€,
- ✓ Zbatimi i masave te Efijencës së Energjisë nene QKMF 2 Istog vlera 131,882.55€

Ne Këto projekte janë duke u vazhduar punimet qe priten të përfundohen brenda pak ditëve .

Komuna e Istogut ne bashkëpunim me FKEE është duke e bvrë projektin për zbatimin e masave te efijences e energjisë për:

- Ndërtesën e Administratës Komunale ne Istog vlera e përafërt e projektit 410,000.00€.
- Ndërtesën e pallatit te Kulturës „Adem Jashari” Në Istog vlera e përafërt e projektit 270,000.00€.

Komuna dhe KFOR kane vendosur panelet solar /fotovoltaike me prodhime te energjisë 10 KË, vlera e projekti t 15,000.00€ është ne Funksion Platforma e Monitorimit dhe Verifikimit (PMV) te efijences se energjisë

Ne bashkëpunim Komuna e Istogut dhe Asociacioni i Komunave te Kosovës dhe GIZ komuna e Istogut është përfitues i projektit për përgatitjen e Planit Komunal për Energji te Qëndrueshme dhe Klime (PKEQK) ang. (SEQAP) .ky projekt është i përfshire ne konventën e Kryetareve te Komunave –Bashkive te Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë

Gjate kësaj kohe është realizuar një vizite pune gjatë muajit maj ne Gjermani „Java e Transportit dhe Ndryshimeve Klimatike 2022 “ne Berlin (Transport andClimateChangeEëek 2022).

ZYRA KOMUNALE PËR KOMITETE DHE KTHIM JANAR-DHJETOR 2022

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (në vazhdim do i referohemi si ZKKK), është përgjegjëse për rritjen mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për sigurinë e qasjes së drejtë të komunitetit në shërbimet publike në nivel komunal. Është pjesë integrale e Komunës dhe strukturës së përgjithshme administrative. Ka një nënzyre, atë në fshatin Cerkolez.

Që nga fillimi, ZKKK ka qenë e inkuadruar në procesin e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe formimit të klimës së duhur për riintegrim të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Istogut.

Struktura e ZKKK-së sipas pozitës, gjinisë dhe përkatnisë etnike, është paraqitur më poshtë.

NR	EMRI DHE MBIEMRI	POZITA	GJINIA
1.	Rasim Mahmutović	Shef i ZKKK-së	M
2.	Enisa Ćorivić	Zyrtare për koordinim të të drejtave dhe integrim të komuniteteve	F
3.	Abedin Neziraj	Zyrtar për koordinim të të drejtave dhe integrim të komuniteteve	M
4.	Muhamed Maleshaj	Zyrtar për integrim dhe drejta të kominiteteve	M
5.	Vesna Maliković	Zyrtare për kthim të qëndrueshëm	F
6.	Esad Samkić	Zyrtar për buxhet dhe financa	M

I. PËRMBLEDHJE

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 35 lëndë.

Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizta të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:

- Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
- Merrë pjesë në mbledhjet e Komiteteve, si: Komitetin për Komunitete, dhe në këtë Komitetë kontribonë dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.
- Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
- Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinjë dhe vendet tjera, me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
- Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, OSCE, DRC etj.

II. KTHIMI I PERSONAVE TË ZHVENDOSUR

- Janë në proces të ndërtimit 2 shtëpi për personat e kthyer nga vendet e Rajonit, që nënkupton 2 familje me gjithse 8 persona.

III. RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIATHDESUAR

Gjatë periudhës raportues, duke u bazuar në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR), në Komunën e Istogut kemi pasur 7 familjes të riatdhesuara, në total 10 persona.

Në bashkëpunim me Zyrtarin e Lartë Regjional për Riintegrim dhe së bashku me Zyrtar nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Istogut, kemi realizuar vizita të njëpasnjëshme tek familjet e riatdhesuar, duke vlerësuar nevojat e tyre për riintegrim të qëndrueshëm e gjithashtu duke i këshilluar dhe asistuar në kompletimin e procedurave për përfitim nga PROGRAMI i Qeverisë së Republikës së Kosovë për Personat e Riatdhesuar.

- Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së

Gjatë periudhës raportuese pranë ZKKK-së, nga persona të riathdhesuar kemi pasur gjithsej 10 kërkesa të parashtruara, prej tyre: 5 për pagesë të qirasë për banim, 3 për pako dimri (dru zjarri), 1 kërkesë për Renovim (e pakompletuar nga pala), dhe 1 kërkesë për orendi (e pakompletuar nga pala).

Komisioni Komunal për Riintegrim (KKR)

Ky komision është i formuar nga Kryetari i Komunës, dhe duke u bazuar në Rregulloren (QRK) 13/2017 dhe Rregulloren QRK 22/2020 Për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, ka kompetenca vendimmarrëse për kërkesat e parashtruara nga personat e riatdhesuar.

Ky komision gjatë këtij viti ka mbajtur gjithsej 2 mbledhje, dhe ka shqyrtuar gjithsej 8 kërkesa nga personat e riatdhesuar, dhe 2 prej tyre janë në pritje të kompletimit të dokumentacionit.

- Ka aprovuar gjithsej 5 kërkesa, dhe ka rekomanduar DRPR-së 3 të tjera.

IV. LËNDËT E PRANUARA NË ZKKK, TË APROVUARA, TË REFUZUARA DHE NË PROCES

ZKKK gjatë këtij viti ka pranuar një numër kërkesa, të natyrave të ndryshme.

Sipas SIK, gjatë kësaj periudhe raportuese ka pranuar kërkesa të llojit si: Riparim të rrugëve me zhavorr, ndihmë financiare, ndihm për mbulim të shpenzimeve mjekësore, ndihmë për pagesë të banimit me qira etj.

Disa nga kërkesa janë shqyrtuar në Komisionin Komunal për Riintegrim, dhe disa prej tyre janë në process të shqyrtimit.

V. SFIDAT

Zyra, sikur të gjitha drejtoritë/ zyrat e tjera, gjatë realizimin të planit të saj të punës.

Ndër sfidat kryesore vazhdon të jetë ndihma për personat e riatdhesuar nga vendet e treta.

Pas përfundimit të periudhës së banimit me qira 6+6 muaj për këtë kategori, sipas Rregullores QRK 13-2017 dhe tani së fundmi Rregullores QRK 22/2020, personat e riatdhesuar kalojnë në kompetecë dhe përgjegjësi të Komunës.

Këta persona vazhdojnë të jenë në vështirësi ekonomike e sociale edhe 1 vit pas riatdhesimit të tyre.

Sfidë tjetër mbetet çështja e zgjidhjes së problemit të banimit për banorët e ish-burgut të gurrakocit, të cilat vazhdojnë të jetojnë në gjendje jo të mirë ekonomike, ku vlenë të ceket se komuna vazhdon të paguaj qiranë për këto familje. Gjatë muajit Qershor 2022, me vendim të Kryetarit të Komunës për verifikimin e gjendjes së familjëve në skemën e strehimit social, komisioni i kryesuar nga zyrtari i ZKKK-së dhe anëtar nga drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Shërbimeve Publike kanë vizituar këto familje dhe kanë dalë me raport të bazuar në procesverbalet e secilit rast individualisht dhe kanë rekomanduar kryetarin e komunës që të vazhdohet me pagesën e qirasë për rastet në skemën e strehimit social.

Komuna Istog
Datë: 31.01.2023



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI